

INSTITUTI I
STUDIMEVE POLITIKE



INSTITUTE FOR
POLITICAL STUDIES



INSTITUTI I
STUDIMEVE
POLITIKE

REFORMA NË DREJTËSI: 2018 BILANCI, PROBLEMATIKAT, SFIDAT



Instituti i Studimeve Politike (ISP) vijon të kryejë monitorimin e ecurisë së reformës në drejtësi. Fokusi i monitorimit janë ecuria e ligjeve të reformës, niveli i zbatimit të ligjit dhe Kushtetutës, bilanci i strukturave të rivlerësimit, ngritja e institucioneve të reja, ligjërimi politik e publik si dhe perceptimi publik mbi reformën në drejtësi, sfidat dhe problematikat

Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e stafit të ISP.

BOTUES

Instituti i Studimeve Politike

Drejtues i projektit

Afrim Krasniqi

Ekspertë të angazhuar

Ervin Karamuço

Rudina Niklekaj

Arben Cara

Doriana Pano

Dorina Berdufi

© Instituti i Studimeve Politike, Tiranë 2018

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. GJETJET KRYESORE TË ECURISË 2018 TË VETTINGUT DHE REFORMËS
 2. REFORMA NGA KUSHTETUTA TEK JETËSIMI: ANALIZA E TIPAREVE KRYESORE
 - 2.1. AFATET KUSHTETUESE DHE PRAKTIKAT NË KUNDËRSHTIM TË TYRE
 - 2.2. KUVENDI DHE PËRGJEGJËSITË E TIJ NDAJ REFORMËS
 - 2.3. PËRGJEGJËSIA EKZEKUTIVE: VONESA, BUOKRACI, MUNGESË STRATEGJIE
 - 2.4. AFATET KUSHTETUESE DHE PRAKTIKAT NË KUNDËRSHTIM TË TYRE
 - 2.5. KUVENDI DHE PËRGJEGJËSITË E TIJ NDAJ REFORMËS
 - 2.6. PËRGJEGJËSIA EKZEKUTIVE: VONESA DHE MUNGESË STRATEGJIE
 - 2.7. NË 18 MUAJ VETËM 10% SUBJEKTE TË RIVLERËSUARA. SKENARË E PASOJA
 - 2.8. NDËRKOMBËTARËT VS VENDORËT MBI BILANCIN E REFORMËS
 - 2.9. NGA 35 SHKARKIME VETËM 2 REAGIME KRITIKE. AKUZA POR JO HETIM
 - 2.10. VETTINGU, NJË ILDKPKI DHE KLD MË E ASHPËR APO NJË STANDARD I RI?
 - 2.11. LIGJËRIMI POLITIK SI PENGESË PËR REFORMËN NË DREJTËSI
 - 2.12. PROBLEMATIKA TË DISPORCIONALITETIT NË KRYERJEN E RIVLERËSIMIT
 - 2.13. RISKU I KALIMIT TË “SHKARKIMEVE” NË GJYKATËN E STRASBURGUT
 - 2.14. KOSTOJA E “VENDIT TË VOGËL” NË SISTEMIN E DREJTËSISË
 - 2.15. SPAK, - SYNIMI KRYESOR I VITIT 2019
 - 2.16. KED, 42% E ANËTARËVE ENDE NUK KANË KALUAR TESTIN E VETTINGUT
 - 2.17. KED, - ROLI I RËNDËSISHËM QË MERR NË MUNGESË TË KONSENSUSIT
 - 2.18. KLGJ DHE KLP U KRIJUAN, POR DISA SFIDA THELBESORE MBETEN
 - 2.19. PRURJET JASHTË SISTEMIT NË KLGJ/KLP: 9 MUAJ ME/PA MANDAT?
 - 2.20. SHKOLLA E MAGJISTRATURËS: KRIZA ZGJIDHET, REFORMA VIJON

 3. VETTINGU GJATË 2018: BILANCI, TIPARET DHE PROBLEMATIKAT
 - 3.1. KPK: KOMISIONERËT MË TË “ASHPËR” DHE MË “LIBERALË”
 - 3.2. NGARKESA E PUNËS SIPAS KOMISIONERËVE
 - 3.3. KOMISIONERËT QË U RRËZUAN NGA ONM/IKP DHE KOLEGJI
 - 3.4. NË 8% TË RASTEVE VENDIMET U MORËN ME 1 VOTË MË SHUMË
 - 3.5. KOLEGJI I POSACËM: SHKARKIME NË 100% TË RASTEVE
 - 3.6. KOMISIONERI PUBLIK: ANIMIME NDAJ 17% TË VENDIMEVE TË KPK
-

1. GJETJET KRYESORE TË ECURISË 2018 TË VETTINGUT DHE REFORMËS

- Reforma në drejtësi vijon të konsiderohet zhvillimi më i rëndësishëm institucional në Shqipëri që prej korrikut 2016. Vetëm pas rreth 2.5 vitesh është arritur të krijohen KLGJ dhe KLP, strukturat thelbësore në kalimin nga procesi i rivlerësimit tek procesi i ngritjes së institucioneve të reja të qeverisjes së drejtësisë në Shqipëri. Procesi i deritanishëm ka ecur me ritme të ngadalta, me vonesa të panevojshme dhe me vështirësi të mëdha politike, sociale dhe profesionale. Në thelbin e vet reforma në drejtësi më shumë po vijon si produkt i imponuar nga jashtë (me nxitje të fortë nga BE, SHBA dhe institucionet perëndimore) sesa si produkt i brendshëm (me mbështetje nga aktorët institucionalë dhe politikë).
- Pas 2.5 vitesh reforma në arritur të ketë bilancin e parë në dy nivelet e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Deri tani rreth 16 subjekte rivlerësimi kanë dhënë dorëheqje nga funksionet në sistemin e drejtësisë, 77 subjekte rivlerësimi kanë kaluar përmes procesit të vettingut në KPK, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka dhënë 12 vendime dhe se 28 vendime janë ende në shqyrtim prej tij. Në total IKP/ONM kanë bërë 16 apeline të vendimeve të KPK, si dhe nga lista prioritare prej 57 subjekteve të rivlerësimit janë ende pa vendim të KPK vetëm 2 subjekte.
- Suksesi i deritanishëm i reformës në drejtësi është modest, por reforma nuk ka kthim pas. Vendimet e KPK për të shkarkuar nga funksionet 35 subjekte rivlerësimi, midis të cilëve pjesën më të madhe të Gjykatës Kushtetuese, një pjesë të Gjykatës së Lartë dhe disa drejtues të rëndësishëm të gjykatave dhe të prokurorive në rrethe, janë mirëpritur në publik dhe janë shënuar si zhvillime “revolucionare” në një vend, ku për vite më rrallë individët e pushtetshëm nuk kanë mbajtur dhe as dhënë përgjegjësi përballë akuzave për korrupsion, abuzim me pushtetin, lidhje me krimin ose paaftësi.
- Fokusi kryesor i dy viteve të fundit ka qenë vettingu, pra përjashtimi nga sistemi i individëve që nuk plotësojnë njërin prej tre kritereve kushtetuese, duke lënë jashtë vëmendjes aspektet e tjerë të rëndësishme të reformës, prurjet e reja në sistem, sistemin e karrierës, përmirësimin e cilësisë së punës në dhënien e drejtësisë, transparencën dhe rritjen e pavarësisë dhe profesionalizmit. Vettingu nuk është reforma në drejtësi, por vetëm një prej fazave të saj përbërëse.
- Vetë procesi i vettingut ka nxjerr në pah devijimet e dukshme nga afatet, standarde të dyfishta në gjykimin e të njëjtave problematika, presionet politike dhe nga grupet e interesit, diferencat në formim e gjykim midis vetë strukturave të vettingut, dominim të vlerësimit vetëm në komponentin e pasurisë duke evituar vlerësimin mbi aftësinë apo integritetin, si dhe mungesë të një strategjie të qartë të KPK/IKP/KPA lidhur me subjektet prioritare në rivlerësim dhe reflektimin ndaj ankesave që vijnë nga publiku. Disa komisionerë morën vendime që u provuan të gabuara, si dhe 8% e vendimeve u përcaktuan nga 1 votë diferencë. Strukturat e vettingut dhe personeli ndihmës kanë nevojë për trajnim profesional dhe se vetë KPA duhet të njehsojë standardet e vlerësimit.

- Në fundin e vitit 2018 është ngritur KLGJ dhe KLP, është formatuar KED e përkohshme, është ngritur Komisioni Koordinues në Kuvend për reformën në drejtësi, dhe se me fillimin e vitit 2019 nis procesi konkurrues për SPAK, vendet vakante në Gjykatën e Lartë e Kushtetuese, si dhe për postet e tjera të sistemit të ri të drejtësisë. SPAK u përdor shumë në retorikën politike, ndërkohë që ajo nuk ekziston ende. Vijon të ketë hendeq të dukshëm midis premtimeve të faktorit politik për reformën, pritshmërive publike dhe kapaciteteve të organeve e vullnetit real politik për jetësimin e reformës, sidomos të SPAK dhe BKH.
- Gjykata Kushtetuese është prej muajsh jo funksionale, Gjykata e Lartë është në limitet e legjitimitetit të vendimmarrjes dhe se me ecurinë e procesit të vettingut pritet që të krijohet boshllëk edhe në nivelet e tjera të gjyqësorit, sidomos në gjykatat e apelit dhe ato administrative. Autorët e reformës në drejtësi duhej ti kishin marrë parasysh këto situata për të ofruar rrugëzgjdhje optimale ligjore dhe parandaluar krizat institucionale. Teza e përfitimit afatgjatë në kushtet e gjendjes afatshkurtër pa institucione funksionale të drejtësisë, është e gabuar, dhe dëmtuese për besimin publik tek reforma.
- Parlamenti ka marrë shumë më tepër kohë sesa duhej për të miratuar ligjet e paketës së reformës në drejtësi dhe pas 2.5 vitesh ende disa prej ligjeve nuk janë miratuar. Struktura e Komisionit Koordinues u ngrit me shumë vonesë dhe përbërja e tij lë për të dëshiruar. Qeveria vijoi të jetë e vonuar dhe të demonstrojë mungesë strategjie në përmbushjen e detyrimit të saj ligjor për mbështetje cilësore e në kohë të organeve të vettingut dhe të drejtësisë me infrastrukturën e nevojshme.
- Vettingu në drejtësi u bë lajtmotiv për aplikimin e të njëjtës praktikë edhe në politikë, në media, në qarqet akademike, në sport, etj, - një tregues se publiku e sheh pozitivisht procesin dhe një shenjë e lodhjes së shoqërisë nga establishmenti vendimmarrës por edhe shenjë e keqpërdorimit të konceptit të vettingut për nevoja politike e populiste.
- Ligjërimi politik dhe publik ndaj reformës në drejtësi tregon se aktorët politikë e keqpërdorin reformën në funksion të agjendave ditore politike dhe nevojës për denigrimin e rivalëve politikë, duke nxitur interpretimin politik të çdo akti të reformës në drejtësi dhe duke ndikuar kështu edhe në rënien e besimit të publikut tek produktet e reformës.
- Periudha e tranzicionit nga vettingu dhe ngritja e institucioneve të reja, deri në jetësimin tërësor dhe funksionimin e plotë të tyre, po përdorët nga grupe të ndryshme brenda vetë sistemit gjyqësor dhe të drejtësisë për të përfituar maksimalisht përmes mohimit të dhënies së drejtësisë ose akteve të dyshimta për korrupsion. Kjo kategori pritet të japë dorëheqje në momentet e afrimit të procedurave të vettingut të tyre. Mungesa e lidhjes integrale midis vendimmarrjes për shkarkim nga KPK/KPA me pasojës me hetim e vendosje përpara drejtësisë të subjekteve që provohen se kanë shkelur ligjin, u ka dhënë fushëveprimi dhe imunitet individëve ende të pashkarkuar por me kredenciale negative në sistemin e drejtësisë, si dhe ka cenuar mbështetjen publike për thelbin e reformës në drejtësi.

2. REFORMA NGA KUSHTETUTA TEK JETËSIMI: ANALIZA E TIPAREVE KRYESORE

Gjatë vitit 2018 ISP është fokusuar në monitorimin e reformës në drejtësi. Sfida kryesore e këtij viti ishte parashikuar krijimi dhe funksionimi i institucioneve të reja të drejtësisë, KED, KLGJ, KLP, ILD, etj, si dhe zhvillimi i procesit të rivlerësimit për dy listat prioritare të përcaktuara nga KPK. Më optimistët parashikonin edhe krijimin e SPAK dhe BKH, si dhe ndikimin e sistemit të ri të drejtësisë në reformimin tërësor të institucionit të së drejtës në Shqipëri.

Në përfundim të vitit 2018 shumica e objektivave nuk janë përmbushur. Procesi ka ecur me vonesa dhe në disa faza kohore ka kapur ritme më të shpejta, janë arritur rezultate të rëndësishme në procesin e vettingut, por ka pasur edhe kontestime ndaj këtyre rezultateve, vlerësimi ndërkombëtar ishte shumë më optimist sesa vlerësimet e ardhura nga aktorët e brendshëm politikë e civilë, dhe se një numër pasojash rezultoi se nuk ishin parashikuar nga hartuesit e reformës.

Një nga mësimet e nxjerra nga ecuria e deritanishme e reformës në drejtësi është gabimi i bërë në kalkulimet politike të 21-22 korrikut 2016. Kuvendi, nën presionin ndërkombëtar, votoi ndryshimet e reja kushtetuese lidhur me reformën në drejtësi. Por natyra konsensuale e vendimit të Kuvendit nuk vijoi të ruhej në votimin e ligjeve bazë të reformës në drejtësi, të cilat ishin pjesë thelbësore e ndryshimeve, të procesit të vettingut dhe të ngritjes e funksionimit të institucioneve të reja të drejtësisë.

Vota konsensuale e korrikut 2016 nuk u përsërit për shumicën e ligjeve të tjera të paketës së reformës në drejtësi, të cilat morën shumë më tepër kohë sesa ishte parashikuar. Mazhorancë e përdori klimën mbështetëse ndërkombëtare për imponuar ligje që krijojnë situatë të favorshme menaxhimi prej saj në sistemin e ri të drejtësisë, opozita e përdori veton për votën e shumicës së cilësuar për të imponuar mekanizma garancie në formatimin e institucioneve të reja.

Organet e reja të vettingut në drejtësi u miratuan në prag të zgjedhjeve parlamentare 2017, përmes një konsensusi të gjerë politik. Miratimi u bë me vonesë të gjatë kohore, si dhe përmes një kompromisi të minutës së fundit, përmes të cilës, dy palët kryesore politike, nxorën përfitime indirekte duke devijuar parimet fillestare mbi të cilat ishte formatuar reforma në drejtësi. Zgjedhja e strukturave të vettingut u bë përmes një konsensusi të heshtur partiak, duke prodhuar struktura, të cilat, në të paktën gjysmën e saj, përfaqësojnë standarde minimale deri mesatare të profesionalizmit dhe të prestigjit në sistemin e drejtësisë. Në zgjedhjen e strukturave të vettingut pati devijim edhe nga parimet kushtetuese 2016, duke përfshirë në organet e vettingut edhe individë me angazhime të larta politike e partiake në vitet e fundit, ndërkohë që kriteri 10 vjeçar i mosangazhimit në nivele të larta partiake nuk u respektua. Nevoja për të ecur përpara shpesh u përball me konsensusin e heshtur për të injoruar standardet më të larta, transparencën apo parimet kushtetuese.

Pavarësisht këtyre vlerësimeve, nuk ka asnjë dilemë se reforma në drejtësi është zhvillimi më i rëndësishëm dhe më pozitiv që ka ndodhur në Shqipëri prej shumë vitesh. Duke qenë një eksperiment ndërkombëtar, pritshmëritë ndaj saj janë të mëdha dhe se kjo rëndësi e pritshmëri e bën atë qëllim thelbësor për ndryshimin e gjendjes së shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Në të gjitha anketimet e zhvilluara në qendrat universitare, në monitorimin e ligjërimit politik e publik, si dhe në intervistat e zhvilluara me ekspertë të jashtëm ka një perceptim të përgjithshëm që krijon idenë se reforma në drejtësi është vetë procesi i vettingut, pra testimi dhe shkarkimi i individëve që kanë kredenciale negative në deklaratimet e pasurisë, në anën profesionale dhe në çështjet e integritetit moral. Ky identifikim i vettingut me reformën në drejtësi lidhet me zhvillimet e vitit 2018 në reformën në drejtësi dhe me faktin se ligjërimit politik e publik ka folur vazhdimisht me prioritet për vettingun, jo për fazat e tjera pasuese të tij.

Për të bërë dallimin midis vettingut si një fazë e rëndësishme e procesit të reformës, por jo si e gjithë reforma, kohët e fundit ka pasur ndërhyrje kryesisht nga ish ekspertët e lartë të reformës në drejtësi apo vetë misioni i ONM. Konkretisht, në fundin e muajit dhjetor 2018, edhe shefja e ONM, Calavera, në një deklaram vjetor të bilancit dhe sfidave për reformën në drejtësi, vuri theksin në faktin se “viti i kaluar dëshmoi fillimin e një procesi që do të kërkojë kohë dhe vetë vettingu është vetëm një pjesë e vogël e reformës së gjyqësorit dhe e transformimit të përgjithshëm të cilit Shqipëria do të vazhdojë t’i nënshtrohet në të ardhmen për konsolidimin e shtetit të së drejtës”. Pra vettingu është vetëm faza e parë e procesit, por fazat e tjera, sidomos ato të prurjeve të reja në sistem, të krijimit të institucioneve të reja të drejtësisë, të pjekurisë së tyre për të funksionuar në një mjedis të ri kushtetues, politik e social, etj, si dhe sprova që sistemi i ri të japë drejtësi, janë e mbeten de facto shumë më të rëndësishme sesa vetë vettingu.

Një gjyqësor i fortë dhe i pavarur është kritik për të sjellë për popullin shqiptar rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Shtetet e Bashkuara mbeten plotësisht të angazhuara në mbështetjen e Shqipërisë për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe cilësor, i cili sjell drejtësinë për të gjithë qytetarët shqiptarë.

US EMBASSY IN TIRANA

2.1. AFATET KUSHTETUESE DHE PRAKTIKAT NË KUNDËRSHTIM TË TYRE

Vota unanime dhe duartrokitjet e shumta që u shfaqën mesnatën e 22 korrikut 2016 për ndryshimet kushtetuese dhe nisjen e reformës në drejtësi krijuan pritshmëri të larta se shumë shpejt sistemi i mohuar apo i privuar i të së drejtës do të ndryshonte tërësisht. Vetë hartuesit e Kushtetutës së re, misionet ndërkombëtare, BE, SHBA dhe ekspertët e nivelit të lartë ishin aq optimistë një parashikimet e veta sa që vendosen data dhe afate 6-8 mujore për ngritjen e institucioneve të reja.

Konkretisht, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë (të ndryshuar 2016), neni 179, pritej që KLD do të funksiononte përkohësisht deri në mars 2017 dhe ndërkohë, të gjitha kompetencat e drejtimit në gjyqësor e prokurori do të kalonin tek institucionet e reja që pritej të krijoheshin në janar 2017. Konkretisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të duhej të ndodhte përpara datës 11 janar 2017, pra 6 muaj nga hyrja në fuqi e ndryshimeve të reja kushtetuese. Gjithashtu, do të duhej që brenda dhjetorit

Një gjyqësor i fortë dhe i pavarur ka rendësi për të dhënë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit. BE-ja dhe Shtetet e saj Anëtare mbeten plotësisht të përkushtuara për ta mbështetur Shqipërinë në ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe cilësor, që jep drejtësi për të gjithë qytetarët shqiptarë.

SHEFAT E MISIONEVE TE

2016 të ngrihej nga Kuvendi Komisioni Koordinues për reformën në drejtësi, si dhe brenda marsit 2017 të ngrihej dhe të bëhej funksionale Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Rreth 2.5 vjet nga ndryshimi kushtetues i korrikut 2016, bilanci i krijimit të institucioneve në respekt të Kushtetutës, është dhe mbetet kritik. KLGJ dhe KLP janë ngritur rreth 22 muaj më vonë, Inspektori i Lartë nuk është ngritur ende dhe madje nuk janë realizuar ende procedurat e kandidimit dhe të vettingut, KED është bërë funksional pjesërisht vetëm pas 21 muajsh, KLD ka vijuar të ketë mandat dhe aktivitet edhe mbi 20 muaj të tjerë nga mandati i parashikuar kushtetues dhe se Komisioni i Koordinimit në Kuvend është ngritur po ashtu, 22 muaj me vonesë. Tabela e mëposhtme paraqet devijimet në kohë (ditë e muaj) të afateve kushtetuese për ngritjen e institucioneve bazike të sistemit të ri të drejtësisë.

INSTITUCIONET E DREJTESISË	AFATI	U KRIJUAN	DIFERENCA / VONESA
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR	11.01.2017	12.12.2018	660 DITE / 22 MUAJ
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË	11.01.2017	11.12.2018	660 DITE / 22 MUAJ
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË	11.01.2017	-	680 DITE / 22.6 MUAJ
KOMISIONI KOORDINUES NË KUVEND	30.12.2016	05.11.2018	675 DITE / 22.5 MUAJ
KED BËHET FUNKSIONAL	11.03.2017	07.12.2018	630 DITE / 21 MUAJ
SHKRIHET KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË	11.03.2017	11.12.2018	635 DITE / 21 MUAJ

Gjatë kësaj periudhe pati edhe një numër të madh afatesh të tjera kushtetuese e ligjore që u shkelën. Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë prej më se dy vitesh nuk kryen asnjë zëvendësim të anëtarëve të saj, ndaj edhe sot ndodhet në gjendje paralize të plotë (GJK) ose të pjesshme (GJL). Pasojat u përshkallëzuan edhe në nivelet e tjera të gjyqësorit. Për shembull, në qershor 2018 KLD bëri publike shqetësimin e krijuar për shkak se 11 kryetarëve të gjykatave u ka përfunduar mandati në drejtim dhe se brenda vitit 2018 do të mbaronte mandati edhe për 11 kryetarë të tjerë.

Prej dhjetorit 2017 Shqipëria vijon të ketë një Prokuror të Përgjithshëm të Përkohshëm, ndërkohë që në momentin e zgjedhjes së saj, u premtua nga Kuvendi se mandati i përkohshëm do të ishte vetëm 2-3 mujor. Pas 13 muajsh, ende nuk ka nisur praktika kushtetuese dhe ligjore e zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm.

Shkelje flagrante të afateve ligjore shfaqen edhe në punën e organeve të reja të vettingut, strukturat që bëjnë rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pothuajse asnjë subjekt i rivlerësimit nuk është vlerësuar e gjykuar brenda afatit ligjor që parashikonte ligji 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH. Afatet janë respektuar vetëm në pjesën e komunikimi midis KPK, IKP dhe KPA, pra në fazën e gjykimit të subjekteve të rivlerësimit, jo në fazën e hetimit dhe të verifikimeve.

2.2. KUVENDI DHE PËRGJEGJËSITË E TIJ NDAJ REFORMËS

Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë ka disa përgjegjësi direkt dhe indirekte që lidhen me jetësimin e reformës në drejtësi. Përgjegjësia e parë lidhet me kalimin në shqyrtim dhe votimin e të gjitha ligjeve të reformës në drejtësi.

Deri në dhjetor 2018 Kuvendi ka miratuar 27 ligje, ndërkohë që të paktën 10 ligje të tjera të parashikuara në paketën e reformës në drejtësi nuk janë miratuar ende. Ekzistojnë edhe ligje të tjera të parashikuara në planin e punës të reformës, si p.sh, ligji mbi Presidentin e Republikës, i cili fillimisht ishte parashikuar të kalonte si pjesë e paketës së reformës në drejtësi brenda vitit 2018, por më pas është hequr nga lista e ligjeve të reformës. Nuk ka asnjë vendim mbi organin që ka marrë këtë vendim, siç nuk ka asnjë dokument zyrtar që përcakton se përse fillimisht është parashikuar dhe më pas është hequr nga paketa e ligjeve të reformës, pavarësisht se një grup pune ka punuar dhe përgatitur draftin e ligjit. Vendimmarrje të tilla ekstra institucionale, kryesisht përmes kanaleve indirekte të komunikimit (qeveri, misioneve ndërkombëtare etj) pa transparencë dhe informim publik, janë tregues kritik mbi cilësinë e vendimmarrjeve dhe standardeve të munguara të transparencës.

Me vendimet 41/2017 dhe 78/2017 të Gjykatës Kushtetuese janë shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën disa nene të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Shfuqizimi ka krijuar boshllëk ligjor në praktikën e emërimeve ose ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në punën dhe vendimmarrjen e KLGJ dhe KLP, etj. Sipas praktikës kushtetuese, do të duhej që Kuvendi i Shqipërisë të investohej për reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në legjislacionin përkatës, përgjegjësi që Kuvendi nuk e ka përmbushur ende, pavarësisht se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë dalë prej më shumë se 1.5 vitesh.

Në tetor 2018, pas më shumë se një viti vonesë, Kuvendi ngriti Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (KPKMN). Anëtarët u zgjodhën në dy faza, katër më 20 shtator (Artan Spahiu, Irena Nino, Lindita Rusmali dhe Saimir Vishaj) si dhe një anëtar më 25 tetor (Petrit Plloçi). Ky i fundit është i vetmi anëtar me përvojë të gjatë drejtuese në sistemin e drejtësisë, duke qenë edhe ish anëtar në Gjykatën Kushtetuese për më shumë se 10 vjet. Në tërësi përbërja e Komisionit ishte nën pritshmëritë publike dhe pa përbërje të atillë cilësore që të mund të ketë impakt pozitiv publik. Të dhënat për anëtarët, përfshirë CV personale nuk janë bërë asnjëherë publike nga Kuvendi dhe as nga vetë Komisioni.

Më 5 nëntor Komisioni u bë funksional, si dhe zgjodhi kryetarin e vet, z.Artan Spahiu. Deri në fundin e dhjetorit 2018 Komisioni ka nxjerrë vetëm një vendim, “Raport mbi procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi (KPED)”, raport që krijoi bazën për një zgjidhje emergjente për KED në mungesë të strukturave të tjera furnizuese të anëtarësisë së saj.

2.3. PËRGJEGJËSIA EKZEKUTIVE: VONESA DHE MUNGESË STRATEGJIE

Në fundin e vitit 2017 KPK dhe KLA kërkuan në Kuvendin e Shqipërisë rritje të numrit të personelit ndihmës dhe administrativ, si dhe financim më të madh në funksion të efikasitetit të aktivitetit të tyre. Kërkesa e tyre u konsiderua e parakohshme nga Kuvendi, qeveria dhe një numër partnerësh, përfshirë zyra të rëndësishme ndërkombëtare. Gjatë vitit 2018, me problematikat dhe vonesat e krijuara në procesin e rivlerësimit u konstatua se KPK dhe KLA kanë

mungesë në personel profesional ndihmës dhe mungesa të tjera, për të cilat parlamenti e korrektoi vendimmarrjen e tij, duke miratuar rreth 10 muaj me vonesë një paketë ndryshimesh në personel dhe në buxhet.

Gjithashtu, që nga krijimi i strukturave të vettingut, qeveria kishte përgjegjësinë të siguronte mjedise të përshtatshme dhe funksionale pune. Për një periudhë të gjatë kohore rreth 9 muaj, KLA mbeti në mjedise të përkohshme, ndërkohë që për strukturat e tjera, përfshirë KPK dhe IKP periudha e tranzicionit ishte më e shkurtër. Gjatë vjeshtës së vitit 2018 pati përsëri ndryshime në mjediset e punës të ofruara nga qeveria, sidomos për KPK, çfarë solli kufizim të hapësirës për seancat dëgjimore dhe kritika nga shoqëria civile për kufizim edhe të transparencës publike.

Në fundin e vitit 2018 qeveria është duke projektuar një vendimarrje tjetër dhe ri-zhvendosje të të gjithë strukturës së vettingut në një mjedis të ri. Ndërkohë, krijimi i KLGJ dhe KLP gjithashtu solli vështirësi teknike dhe administrative në funksionimin e tyre. Nëse KLGJ trashëgon mjediset e ish KLD-së, KLP ende nuk ka mjedise zyrtare dhe të dedikuara pune. Fakti që qeveria nuk arriti për më shumë se 1 vit kalendarik të parashikojë strukturat e reja dhe detyrimet e saj administrative ndaj tyre, mbetet një tregues kritik i mungesës së sensit të përgjegjësisë dhe të vendimmarrjes strategjike për reformën në drejtësi.

Një prej pasojave të këtyre akteve ka impakt direkt edhe publik, pasi zhvendosjet e vazhdueshme ose mjediset e përkohshme kanë pamundësuar një sistem transparent informimi të vazhdueshëm për përbërjen, funksionet, vendimmarrjet, mbledhjet dhe elementë të tjerë të aktivitetit të punës së strukturave të reja të drejtësisë.

Për shembull, ende në fundin e vitit 2018, nuk ka një faqe interneti të dedikuar për aktivitetin e KED, KLGJ, KLP, Komisionit të Koordinimit në Kuvend dhe as CV zyrtare të anëtarëve të tyre. Në mungesë të tyre pjesa tjetër e paketës së transparencës, siç janë njoftimet e rregullta, aktet e rregullimit të brendshëm, komunikimi i vendimmarrjes, kopjet e dokumenteve që nuk përbëjnë konfidencialitet, procesverbalet që përbëjnë bazë për akses publik, etj, mungojnë pothuajse tërësisht.


2.4. NË 18 MUAJ VETËM 10% SUBJEKTE TË RIVLERËSUARA. SKENARË E PASOJA

Në përfundim të vitit të dytë të reformës në drejtësi dhe të procesit të rivlerësimit është arritur të bëhet vettingu i vetëm rreth 10% e të gjithë numrit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Shqipëri. Me këtë ritëm duket teorikisht e pamundur të arrihet që vettingu të realizohet për të gjithë trupën gjyqësore dhe të prokurorisë brenda afatit të parashikuar kushtetues 5 vjeçar.


Vonesat në periudhën e parë të vitit 2018 dhe në tremujorin e tretë të vitit 2018, ashtu si edhe mbivendosjet në listën prioritare të subjekteve të rivlerësimit, krijuan përshtypjen se kemi të bëjmë me një proces shumë më kompleks sesa ishte parashikuar si dhe me interesa pragmatiste që lidhen me to. Konkretisht, referuar të dhënave nga KPK, IKP dhe KPA rezultoi se krahas 16 subjekteve që kanë dhënë dorëheqje, janë 77 raste të përfunduara në gjykimin në nivelin e parë dhe 12 në nivelin e dytë. Në total janë shkarkuar 22 gjyqtarë, 12 prokurorë dhe 1 ndihmës ligjorë, si dhe janë konfirmuar në detyrë 20 gjyqtarë, 18 prokurorë dhe 4 ndihmës ligjorë.

Siç shihet nga tabela, në total kemi 42 gjyqtarë të trajtuar në KPK, 30 prokurorë dhe 5 ndihmës ligjorë. Sipas kategorive, numri i gjyqtarëve të shkarkuar është më i lartë sesa numri i gjyqtarëve

të konfirmuar në detyrë (22 me 20), ndërkohë që numri i prokurorëve të konfirmuar në detyrë është më i lartë sesa numri i prokurorëve të shkarkuar (18 me 12).



Të dhënat e paraqitura në përqindje tregojnë se në total, 45% e subjekteve që kanë kaluar deri më tani për rivlerësim janë shkarkuar nga detyra, 55% janë konfirmuar në detyrë, 31% janë e subjekteve të konfirmuara janë ankimuar nga IKP/ONM dhe se 69% e subjekteve të konfirmuara nuk janë ankimuar duke lënë në fuqi vendimin final nga KPK.



Ekziston një opinion i përgjithshëm në nivelin e parë të komisionerëve të rivlerësimit se nëse brenda 5 viteve nuk arrihet kryerja e vettingut të plotë për të gjithë trupën gjyqësore dhe të prokurorisë, atëherë të mbetet e hapur mundësia e nismës kushtetuese për shtyrjen e mandatit të këtyre organeve. Një vendim i tillë do të ishte devijim nga parimet mbi të cilat u ngrit reforma në drejtësi më 2016 dhe një shqetësim i madh për integritetin e procesit. Strukturat kushtetuese të procesit të rivlerësimit kanë përgjegjësinë kushtetuese të veprojnë brenda afateve kushtetuese e ligjore, si dhe të ofrojnë standarde të larta vlerësimi brenda afatit kohor të parashikuar.

Një numër tjetër subjektësh për rivlerësim, të kontaktuar edhe nga stafi i ISP gjatë intervistave dhe anketimeve të ndryshme synon të mos kandidojë për poste drejtuese në sistemin e ri, dhe kështu, të mos bëhen pjesë e listave prioritare të rivlerësimit. Ata llogarisin ecurinë e deritanishme të procesit dhe me këtë ritëm kritik, parashikojnë se në një proces normal rankimi, emrat e tyre mund të jenë në listat e rivlerësimit pas 2-3 vitesh, duke iu dhënë kohë të mjaftueshme atyre për të dhënë dorëheqje nga procesi, dhe kështu për të shmangur përballjen me verifikimin e pasurisë, integritetit dhe pasurisë së tyre. Gjatë kësaj periudhe kohore në ushtrimin e mandatit deri në dorëheqje ose deri në radhën e kryerjes së vettingut, pjesa e korruptuar e sistemit të drejtësisë vijon të jetë aktive, dhe de facto, jashtë kontrollit ligjor e kushtetues.

Nga ana tjetër, një pjesë më e vogël e tyre, parashikojnë se për shkak të ngadalësisë së procesit, një përqindjeje jo të vogël të subjekteve të rivlerësimit nuk do të arrijnë tu bëhet vettingu gjatë periudhës 5 vjeçare të mandatit kushtetuese të nivelit të parë të rivlerësimit. Sipas Kushtetutës, nëse ka ende subjekte pa rivlerësim pas këtij afati, atëherë vettingu realizohet nga KLGJ dhe KLP, struktura që janë shumë më pak të imunizuara sesa strukturat aktuale të KLP, KP, KLA, etj.

Lista e dorëheqjeve nga procesi i vettingut nuk ka pësuar ndryshime thelbësore nga lista paraprake e fillimit të vitit 2018. Midis individëve që kanë dhënë dorëheqje gjenden subjekte të akuzuara për korrupsion, subjekte që largohen për arsye moshe ose angazhimi në profesione të tjera, si edhe subjekte që konkurrojnë për poste të tjera, për të cilat do të kërkohet një proces rivlerësimi në një fazë tjetër.

2.5. NËRËKOMBËTARËT VS VENDORËT MBI BILANCIN E REFORMËS

Reforma në drejtësi u jetësua përmes investimit të vazhdueshëm dhe të jashtëzakonshëm të institucioneve ndërkombëtare në Shqipëri, sidomos BE dhe SHBA. Në një editorial të shpërndarë në median shqiptare më 28 dhjetor 2018, Genoveva Ruiz Calavera drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në KE dhe Shefe e ONM, e konsideroi arritje të rëndësishme krijimin e KLGJ dhe KLP. Ajo citoi numrin 100 të akteve vendimmarrëse të strukturave të vettingut dhe theksoi se “pothuajse gjysma kanë rezultuar me shkarkimin ose dorëheqjen vullnetare të atyre që janë vlerësuar”. Në emër të ONM dhe ekspertëve të tjerë ndërkombëtar Calavera konkludoi se “hetimet e vettingut po kryhen në mënyrë të plotë dhe profesionale”.

Gjatë periudhës 2016-2018 ka një numër të madh rastesh kur përfaqësitë diplomatike perëndimore kanë qenë shumë më aktive dhe më të përfshira në çështje të reformës sesa vetë aktorët politikë dhe institucionet vendore. Deklarimet diplomatike në shumë raste kanë qenë

me tone të forta kritike ndaj aktorëve politikë apo juridikë, paralajmëruese për pasojat dhe nxitëse për ecjen përpara të procesit. Pa një ndërhyrje të tillë, në disa aspekte edhe të pazakontë për vende sovrane, nuk do të ishte arritur miratimi i paketës së ndryshimeve kushtetuese 2016 dhe as pjesa më e madhe e bilancit të deritanishëm të reformës në drejtësi.

Nga ana tjetër, investimi prioritar për reformën në drejtësi ka krijuar kontrast me sjelljen e aktorëve vendorë politikë, me sjelljen e institucioneve vendore shqiptare dhe në disa raste edhe me perceptimin publik ndaj reformës në elementë të ndryshëm të saj.

Për shembull, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018 Shqipëria mbeti de facto pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë funksionale, ndërkohë që mandati i parashikuar 3 muhor i Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme vijon të konsumohet i njëjtë edhe pas 12 muajsh. Në këto rrethana në media dhe në rrethet e shoqërisë civile apo botës akademike, në vetë institucionet e të drejtës dhe në grupe të ndryshme interesi, pati kritika për boshllëkun e krijuar dhe pasojat për shtetin e munguar të së drejtës në Shqipëri.

Të gjitha kritikantët erdhën nga brenda, ndërkohë që faktorët e ndryshëm ndërkombëtarë e justifikuan apriori dhe në unison boshllëkun e krijuar me argumentin e kostos së një reforme të thellë me pritshmëri të mëdha në të ardhmen. Në përputhje me qëndrimin e tërhequr ndërkombëtar për situatën e jashtëzakonshme të krijuar në strukturat e larta shqiptare e ONM deklaroi se *“numri i madh i shkarkimeve, çoi në shtyrjen e formimit të institucioneve të reja gjyqësore dhe ndikoi në funksionimin e institucioneve gjyqësore. Por, sado problematike që janë, kufizimet e përkohshme në funksionimin e sistemit të drejtësisë, të cilat madje kanë rezultuar me humbjen e kuorumit në Gjykatën Kushtetuese, janë të pashmangshme për të ndërtuar një gjyqësor të cilit qytetarët shqiptarë mund t’i besojnë për të respektuar shtetin e së drejtës mbi gjithçka tjetër”*.

Argumenti mund të ketë vlerë në aspektin afatgjatë shumëvjeçar të reformës dhe formatimit të ri të shtetit të së drejtës, por në aspektin afatshkurtër dhe treguesit aktualë të funksionimit të shtetit të së drejtës argumenti është pa bazë dhe çështja meritonte një trajtim më serioz.

Në perceptimin e përgjithshëm publik, sidomos në media dhe në shoqërinë civile, ekziston tashmë opinionimi se institucionet ndërkombëtare dhe faktorët e tjerë ndërkombëtarë të përfshira direkt ose indirekt në reformën në drejtësi në Shqipëri, janë të prirur të ndjekin agjenda dhe prioritete pragmatiste në funksion të mandateve të tyre kohore përfaqësuese në Shqipëri, ndonjëherë kjo edhe në dëm të integritetit afatgjatë të reformës dhe interesit publik.

Reforma në drejtësi mbi të gjitha premtoi dhënien e drejtësisë dhe fundin e periudhës kur drejtësia mohohet ose pamundësohet, ndaj çdo periudhë kohore, përfshirë ajo e vitit 2018, kur drejtësia vijon të jetë e mohuar ose e pamundësuar, - përbën një shqetësim serioz dhe meriton një qasje shumë më realiste sesa projektimet pragmatiste. Edhe vlerësimi për standardet e deritanishme të procesit të vettingut, në aspektet e shumta pozitive por edhe në aspektet kritike të funksionimit, do të duhej të kishte qenë shumë më realist në mënyrë që të nxitte besimin tek reforma dhe të ruhej mbështetja e qëndrueshme publike.

2.6. NGA 35 SHKARKIME VETËM 2 REAGIME KRITIKE. AKUZA POR JO HETIM

Në tërësi, shumica absolute e subjekteve të rivlerësimit të shkarkuara nga KPK apo KPA kanë shfaqur kritika për praktikën dhe standardet e ndjekura në vlerësimin e tyre. Reagimi kritik ishte i pritshëm dhe për disa prej subjekteve, është edhe argument që duhet analizuar pasi të dhënat nga vendimet e deritanishme të KPK nuk bazohen në të njëjtin standard dhe praktikë gjyqimi.

Në listën prej 35 shkarkimeve (gjyqtarë apo prokurorë) vetëm dy raste u shoqëruan me deklarata me konotacion politik. I pati ishte reagimi ish kreut të KED dhe anëtarit të Gjykatës së Lartë (A.Brozi), i cili në një deklaram emocional pas vendimit të KPK tha se *“K.P.K si komisarët politik të kryeministrit nuk dolën dot nga urdhrat politikë. U provova se të ardhurat e mija janë të ligjshme të konfirmuara nga tatimet, kalova në pikëpamjen time të tre testet Pasuror, Profesional dhe Figurën, por nuk kalova dot testin e nënshtrimit për çështje të caktuara dhe atë të Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Beteja ime ligjore do vazhdojë deri në fund”*.

Një tjetër reagim me konotacion politik ishte vlerësimi i ish prokurori të njohur (G.Trenova), sipas të cilit “procesi i vettingut po kuptohet qartë se po bëhet në mënyrë selektive e shoqëruar me presion psikologjik dhe gjobvënie. Procesi i hetimit dhe gjykimit tim është bërë nga persona të paafte apo mediokër, të marrë nga rruga dhe të urdhëruar për të vendosur sipas interesave të politikës. Sa për ONM ajo shërben sa për fasadë për të fshehur padrejtësitë apo për të mbushur me propagandë procesin. Jeta vazhdon me shanse dhe perspektiva të reja”.

Dy deklaramet kanë në thelbin e tyre dyshimin mbi ndikimin politik në procesin e vettingut, si dhe dyshimin për praktika jo profesionale të vendimmarrjes në KPK dhe KLA. Pavarësisht se janë deklarime që vijnë pas vendimeve penalizuese për deklaruesit, nuk ekziston ende një mekanizëm që i merr në trajtim pretendime të tilla, në cilësinë e shqetësimit ose të akuzave, për të hetuar nëse vërtetë ka elementë p.sh, të presionit politik apo të gjobvënës në vendimmarrjet e strukturave të vettingut. Vlera e mbajtjes shënim dhe hetimit do të kishte sens sidomos në drejtim të rritjes së transparencës së vendimmarrjes nga strukturat e vettingut, por edhe të rritjes së besimit publik tek i gjithë procesi dhe tek reforma.

Ecuria e procesit të vettingut ka nxjerrë në pah edhe debatin mbi atë që duhet të pasojë ky proces: nëse kemi raste të subjekteve të shkarkuara që kanë abuzuar me ligjin ose kanë burime financiare jo ligjore, apo të dhëna të tjera që vijnë në kundërshtim përcaktimet ligjore në fuqi, debati është përse vettingu kufizohet në shkarkim dhe nuk ka hetime më pas.

Në një deklaram për median ONM (exit.al) ka deklaruar se *“qëllimi i vettingut nuk është që të zhvillojë procedura penale, por, siç parashikohet në nenin 1 të ligjit të verifikimit, është garantimi i funksionimit të duhur të sundimit të ligjit dhe pavarësisë së vërtetë të sistemit gjyqësor. Prandaj procesi synon të pastrojë sistemin nga magjistratët që nuk i përmbushin standardet e funksioneve të tyre. Nëse sjellja e një subjekti apo (ish)subjekti të rivlerësimit sjell dyshime për vepra penale, dosjet e tyre përkatëse mund të përcillen përmes kanaleve të përshtatshme, siç parashikohet në legjislacionin shqiptar”*.

Fakti është se deri më tani, ka vetëm dy raste kur kanë nisur hetime nga prokuroria, rasti i ish Prokurorit të Përgjithshëm dhe një rast tjetër mos-përputhjes në deklaratën e dekriminalizimit nga një ish anëtar i gjykatës së Lartë.

2.7. VETTINGU, NJË ILDKPKI DHE KLD MË E ASHPËR APO NJË STANDARD I RI?

Gjatë viteve përgjegjësia ligjore për të marrë deklaratat e pasurisë së zyrtarëve, përfshirë të gjyqtarëve e prokurorëve, ka qenë e Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Ky institucion ka mbledhur rregullisht të dhënat e deklaruara të pasurisë dhe ka pasur aksesin ligjor për verifikimin e tyre. Gjithashtu, edhe aspekti tjetër, i sjelljes morale e etike, si dhe i korrupsionit apo paaftësisë profesionale, ka qenë për vite me rralë atribut i KLD-së, një organ tjetër kushtetues i shfuqizuar më 2016. Për Prokurorët gjithashtu ka pasur struktura hetimore dhe gjykimi brenda vetë sistemit të akuzës.

Pavarësisht ekzistencës shumëvjeçare të ILFKPKI-së, KLD-së, Këshillit të Prokurorisë, etj, financimit vendor e ndërkombëtar, trajnimeve pa fund, investimeve në teknologji, raportimeve vjetore në Kuvend, rezolutave të miratuara dhe shkarkimeve apo emërimeve periodike në krye të tyre, - procesi i vettingut me gjyqtarët e prokurorët tregoi se këto struktura nuk kanë qenë efikase dhe as profesionale në nivelin që kërkohej nga ligji. I njëjti vlerësim vlen edhe për organet e tatimeve, hipotekave, drejtorisë që merret me pastrimin e parave, zyrave të bashkëpunimit ndërkombëtar, etj.

Procesi i vettingut gjatë 2018 zyrtarisht u bazua në 3 komponentë, por de facto u aplikua kryesisht vetëm në treguesit e pasurisë. Numri më i madh i shkarkimeve, përfshirë për shumicën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, etj, lidhet pikërisht me akuzat për parregullsi ose pamundësi justifikimi të të dhënave financiare të evidentuara në deklaratimet vetjake ose në hetimet e thelluara mbi to. Pra, indirekt, vettingu u dominua nga hetimi e gjykimi më i thelluar i të njëjtës punë, mision e rol që kishte ILDKPKI. Numri i rasteve të hetimit të nivelit profesional apo i çështjes së integritetit, mbi bazën e të cilave u shkarkuan subjekte të rivlerësimit, është gati minimal.

Kjo disbalancë midis vettingut që largon individët e supozuar të korruptuar, por nuk thellohet tek aftësia profesionale e subjekteve të rivlerësimit, është së pari tregues se kemi të bëjmë me një mekanizëm ekstra që synon të largojë sa më shumë individë nga sistemi, të përmbushë kështu pritshmëritë e larta publike për shkarkime, por së dyti, është edhe tregues se vetë KPK nuk ka kapacitetet e nevojshme profesionale të gjykojë në aspektin profesional gjyqtarë e prokurorë me karrierë të gjatë. Shumica absolute e anëtarëve të KPK, nuk kanë qenë më parë as gjyqtarë, as prokurorë, as avokatë, as staf akademik, dhe as ekspertë të së drejtës, ndaj njohuritë dhe kapacitetet e tyre vendimmarrëse janë të kufizuara dhe dukshëm larg pritshmërive të mëdha që krijoi retorika e reformës në drejtësi dhe premtimi për një sistem shumë më cilësor, më transparent dhe më profesional.

2.8. LIGJËRIMI POLITIK SI PENGESË PËR REFORMËN NË DREJTËSI

Gjatë vitit 2018 ISP monitoroi ligjërimin e aktorëve politikë dhe publikë ndaj reformës në drejtësi. Përmes gjetjeve të shumta u konstatua se aktorët politikë kanë një qasje të gabuar dhe abuzuese ndaj reformës në drejtësi, duke e përdorur atë si mjet denigrimi ndaj rivalëve politikë ose si alibi për dështimet në axhendat e tyre politike. Kjo retorikë më shumë e ka dëmtuar dhe kompromentuar në elementë të veçantë reformën në drejtësi, sesa e ka mbështetur atë. Fuqia e

madhe e partive politike për të mobilizuar anëtarë dhe mbështetës në publik e shoqëruar me investimet e mëdha të tyre në adresim të gabuar për reformën kanë krijuar edhe kosto për nivelin e besueshmërisë dhe mbështetjes publike për reformën si dhe për pritshmëritë publike për të ardhmen e saj.

Mazhoranca në qeveri e ka përdorur vazhdimisht retorikën mbi reformën në drejtësi jo në funksion të reformës, por në funksion të etiketimit negativ të opozitës dhe të linçimit të çdo gjyqtari apo prokurori që ka marrë vendime që cenojnë interesat e saj politike. Ajo me deklaratimet e vazhdueshme ndaj reformës ka krijuar përshtypjen se vetë reforma është një produkt e instrument i saj në luftën politike, një kapital elektoral dhe një mekanizëm presioni ndaj cilitdo që mendon ndryshe ose që nuk është në një linjë me mazhorancën.

Opozita nga ana e saj ka shfaqur të njëjtën sjellje të gabuar ndaj reformës në drejtësi. Nga njëra anë ajo ka kërkuar që standardet e reformës në drejtësi të aplikohen edhe për vettingun në politikë dhe nga ana tjetër i ka refuzuar të gjitha arritjet e deritanishme të reformës në drejtësi, përfshirë ato të vettingut. Me përjashtim të rastit flagrant “Thanza” nuk ende raste të tjera kur opozita ka shprehur mbështetje për ndonjë vendim të organeve të vettingut për shkarkimin e ndonjë subjekti të rivlerësimit, gjyqtar apo prokuror, ndërkohë që ka raste të shumta kur individë të shkarkuar ose të konfirmuar, përkatësisht janë mbrojtur ose denigruar në deklaratime zyrtare dhe politike të opozitës. Ajo ka krijuar idenë se reforma në drejtësi kontrollohet nga qeveria dhe shumicën e vendimmarrjeve lidhur me reformën i ka parë si aksione të koordinuara politike në dëm të axhendës së saj elektorale dhe politike.

2.9. PROBLEMATIKA TË DISPORCIONALITETIT NË KRYERJEN E RIVLERËSIMIT

Në periudhën e hartimit të draftit kushtetues dhe të ligjeve organike në funksion të reformës në drejtësi, nuk janë marrë parasysh një numër pasojash anësore që lidhen me procesin e reformës dhe të vettingut, përfshirë edhe raportin e subjekteve të shkarkuara me angazhimet e tjera publike apo me proporcionalitetin e përfaqësimit në strukturat e reja të drejtësisë. Për shembull, nuk ka kufizim që subjektet e shkarkuara të rivlerësimit, gjyqtarë apo prokurorë, të emërohen pedagogë të së drejtës për vetë juristët e ardhshëm, të jenë drejtues në fakultetet juridike, të jenë drejtues në funksione publike ekzekutive apo të jenë kandidatë në listat e ardhshme elektorale të partive politike. Praktikë absurde e më shumë se një dekadë më parë kur një funksionar i lartë i policisë i arrestuar dhe i dënuar për krim të organizuar dhe trafikim të lëndëve narkotike pas burgimit u emërua pedagog dhe drejtues departamenti në një fakultet juridik mund të ripërsëritet nëse nuk ndiqen standarde të larta në të gjithë sistemin horizontal të zgjedhjes dhe emërimeve.

Gjithashtu, një situatë e re u krijua edhe me zgjedhjen e gjyqtarit shqiptar për në Gjykatën e Strasburgut. Paketa e ndryshimeve kushtetuese nuk parashikonte që për kandidatët për këtë post të kishte një proces vettingu paraprak, i njëjtë me subjektet e tjera të vettingut. Procesi kontrollues dhe filtrues ishte formal dhe administrativ, i njëjtë me praktikën e mëparshme përpara reformë kushtetuese për reformën në drejtësi. Ndaj kandidimi dhe zgjedhja për një post të tillë u bë me standarde të tjera, nga ajo për çdo gjyqtar apo prokuror në Shqipëri, - një raport disproporcionale me vendimmarrjen, mandatin dhe rëndësinë e funksionit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për anëtarët e KLGJ dhe të KLP që vijnë nga “jashtë sistemit”. Ata kaluan një filtër kontrolli administrativ dhe politik përmes procedurës konkurruese dhe votës politike në parlament, por sistemi i vlerësimit të tyre ishte shumë më i ndryshëm dhe natyrisht, shumë më i lehtë sesa procesi për subjektet e rivlerësimit që vijnë nga brenda sistemit. Për shkak se drejtuesit kryesorë të KLGJ dhe KLP janë zgjedhur nga pjesa e prurjeve jashtë sistemit, - krijohet një raport disproporcionale midis pakicës që ka kryer vettingun dhe shumicës vendimmarrëse që ka kaluar përmes një vettingu shumë më formal.

2.10. RISKU I KALIMIT TË “SHKARKIMEVE” NË GJYKATËN E STRASBURGUT

Një numër subjektsh të rivlerësimit janë shkarkuar tashmë nga KPK dhe KLA ose janë në proces vlerësimi përfundimtar nga KLA. Një analizë e detajuar e praktikave të ndjekura, qoftë procedurale qoftë edhe përmbajtjesore, krijon debat nëse kemi pasur standarde të njëjta vlerësimi dhe nëse procedurat ligjore dhe kushtetuese janë respektuar në tërësinë dhe thellësinë e tyre. Për pasojë, është e pritshme që një numër rastesh të vendosin të ndjekin procedurën e ankimimit ligjor të shkarkimit të tyre në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prej disa muajsh në Tiranë janë krijuar ekipe ekspertësh, kryesisht italianë, asistues për ankimime të tilla dhe me siguri, do të ketë ndjekje të kësaj procedure në 2019 ose në të ardhmen.

Në intervistat dhe anketimet që kemi zhvilluar me disa ekspertë të së drejtës, përfshirë anëtarë të stafeve akademike në fakultetet juridike dhe në institucione të ndryshme të së drejtës, janë cituar raste të veçanta të vendimeve të KPK apo KLA që sipas tyre, përbëjnë cenim të të drejtave dhe lirive personale të subjekteve të rivlerësimit, dhe një bazë e mirë për ankimim në Strasburg.

Për strukturat e vettingut dhe reformën në drejtësi është e rëndësishme që çdo vendim të jetë i bazuar në parimet kushtetuese dhe të respektojë të gjithë mekanizmat ligjore të procedurës dhe të drejtave të njeriut, në mënyrë që Shqipëria të mos rrezikojë të penalizohet në të ardhmen për mangësi apo devijime nga këto praktika e standarde. Çdo vendim i mundshëm në Strasburg mund të ketë pasoja të mëdha në integritetin e procesit në vend, dhe sidomos në besueshmërinë dhe nivelin e funksionalitetit të sistemit. Nga ana tjetër, subjektet e rivlerësimit, përfshirë ato që janë shkarkuar ose që janë në proces vlerësimi për shkarkim, kanë të drejtën e tyre kushtetuese për të ndjekur të gjitha procedurat ligjore që u garanton Kushtetuta dhe ligji. Për një pjesë të tyre ankimimi në nivel fundor është edhe një mekanizëm rehabilitimi personal në shoqëri për shkak të denigrimit të imazhit në rastet e shkarkimit nga detyra.

2.11. KOSTOJA E “VENDIT TË VOGËL” NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Shqipëria është një vend relativisht i vogël dhe me burime njerëzore konkurruese të kufizuara, sidomos në sektorë ku kërkohet një CV e gjatë profesionale dhe kritere të forta konkurrimi. Reforma e re në drejtësi nuk e ka marrë në konsideratë këtë fakt, ndaj edhe shpesh, një numër vendimesh, emërimesh, zgjedhjesh, etj, kontestohen ose etiketohen për shkak të lidhjeve që bëhen midis individëve të zgjedhur/emëruar dhe familjarëve të tyre në politikë ose në sektorë të tjerë me ndikim. Për shembull, një analizë e të dhënave për familjarët e afërt të ish anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, KLD-së, Shkollës së Magjistraturës, etj, rezultoi se

rreth 40% e tyre kanë brenda familjeve individë me angazhime paralele në gjyqësor ose prokurori, pra brenda sistemit, ose jashtë sistemit, në politikë dhe institucionet e mandatuara politike. Për pasojë, është e pritshme që për këto raste të ketë debate, kontestime dhe etiketime, apo që koncepti i pavarësisë të lexohet si koncept i pavarësisë relative.

Ndikimet politike dhe familjare, ndikimet lobuese ose promovuese/denigruese nga media, nga biznesi apo nga grupe të tjera me ndikim real në vendimmarrje, natyrisht që janë shfaqur edhe në fazën e tanishme të jetësimit të reformës në drejtësi dhe do të jenë prezent gjatë gjithë procesit në vijueshmëri. Një sistem drejtësie që u akuzua se u ngrit e veptoi si korporatë e mbyllur dhe me lidhje politike, i ka brenda tij edhe të paktën gjysmën e atyre që janë kandidatë potencialë për promovim në ngritjen e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Vetë partitë politike, qeveria, grupet e juristëve dhe ekspertëve të nivelit të lartë të angazhuar në reformën në drejtësi, grupet lobuese juridike në shoqërinë civile apo organizimin e vetë gjyqtarëve e prokurorëve, etj, kanë preferencat e tyre dhe vijojnë të jenë aktive për të promovuar njerëzit e tyre besnikë në postet e reja në sistem ose anasjelltas, për të denigruar apo etiketuar ata që nuk bëjnë pjesë në rrethin e tyre të besuar.

Në këto rrethana zgjidhja më optimale mbetet të gjykohet vetë sistemi gjatë funksionimit të tij në fazën e parë të jetësimit të institucioneve të reja, nëse të zgjedhurit përmes meritës, përmes shortit e rastësive apo përmes lobimeve informale politike e financiare, do të jenë zgjedhja e duhur apo do të kemi përsëritje të sistemit korporativ në kushte e rrethana të reja.

2.12. SPAK, - SYNIMI KRYESOR I VITIT 2019

Në perceptimin e përgjithshëm publik sukcesi në reformën në drejtësi është e lidhur me suksesin e krijimit dhe të funksionimit të SPAK, (Prokuroria e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit). Në të gjitha dokumentet strategjike të reformës në drejtësi parashikohej se ngritja e SPAK dhe e BKH do të ndodhte në mesin e vitit 2017 deri në fillim të vitit 2018. Sipas legjislacionit të reformës, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) do të duheshin të ngriheshin përpara muajit maj 2017. Ato u ngritën vetëm në dhjetor 2018, rreth 20 muaj më vonë sesa parashikimi ligjor.

Prokuroria e Posaçme (SPAK) përbëhet “nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi”. Sipas ligjit 195/2016 kandidatët për prokurorë bëjnë aplikim brenda dy javëve nga lajmërimi nga KLP. Kushtet për kandidatët janë: kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës; si dhe dhënia e pëlqimit për veten dhe familjaret e tij/saj për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake. Komisioni Koordinues për reformën pranë Kuvendit ka paralajmëruar se më 10 shkurt është afati për ngritjen e strukturave të SPAK dhe GJKKO, dy struktura të rëndësishme e pritshmëri të lartë për luftën ndaj krimin dhe korrupsionit në Shqipëri. Kryetari i ri i KLP ka deklaruar se procesi i emërimeve në SPAK me kandidatët që aspirojnë dhe që kanë kaluar vettingun mund të jetë i shpejtë, kurse për kandidatët e tjetër procesi i rivlerësimit do të ndjekë rrjedhën normale.

Parashikimi duket shumë më optimist sesa mundësitë realiste. Për të konkurruar për postet e reja, sidomos në SPAK, do të duhen një numër i madh kandidatësh që kanë ambicie personale

për kandidim. Ligji parashikon të paktën 10 kandidatë fitues, duke nënkuptuar nevojën e të paktën 15-20 kandidatëve për 10 vende në dispozicion. Duke llogaritur që vettingu për subjektet e deritanishme të rivlerësimit ka marrë minimalisht 8 ditë për çdo subjekt të konfirmuar në detyrë dhe mbi 124 ditë për subjektet e shkarkuara, atëherë do të kërkohej të paktën 80 ditë për vettingun e kandidatëve, nëse të gjithë do të konfirmohen në detyrë. Nëse pjesë e kandidimit do të jenë subjekte që tashmë janë rivlerësuar dhe janë konfirmuar në detyrë, kjo hapësirë kohore shkurtohet, megjithatë vendi vakant që ata krijojnë në sistem, sjell pasoja me efekt domino në nivelet e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

Sugjerimi i Komisionit Koordinues ndaj KPK për të zhvendosur në listë prioritare kandidatët për SPAK apo Gjykatën Speciale, nuk merr në konsideratë nevojën më emergjente për të trajtuar në procesin e rivlerësimit kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, poste si ai për Prokurorin e Përgjithshëm apo garën për Inspektor të Përgjithshëm. Për më tepër, asnjë organ nuk ka kompetencë për të diktuar axhendën e vendosur nga vetë KPK, me listën e parë dhe të dytë prioritare dhe me praktikën e punës së ndjekur deri tani, e cila gjithsesi ka krijuar shpeshherë debate mbi prioritetet dhe standardet e përcaktimit të prioriteteve.

2.13. KED, 42% E ANËTARËVE ENDE NUK KANË KALUAR TESTIN E VETTINGUT

Kuvendi organizoi hedhjen e shortit për KED më 7 dhjetor 2018. Dy kandidaturat e Gjykatës Kushtetuese ishin problematike, - një kandidat në proces vettingu në Kolegjin e Apelit (u shkarkua një javë më pas), dhe kandidatura e dytë një anëtare e Gjykatës Kushtetuese me mandat të përfunduar dhe njëherësh kandidate për një post tjetër të lartë, kryetare në KLSH. Nga Gjykata e Lartë gjithashtu pati një të zgjedhur, njëherësh edhe kandidat për Gjykatën Kushtetuese dhe një zëvendësues, njëherësh kandidat tashmë i zgjedhur në KLGJ. Nga Prokuroria e Përgjithshme pati vetëm një kandidat, pa zëvendësim, Prokuroria aktuale e Përgjithshme. E njëjta situatë u paraqit edhe nga prokurorët e apelit, me vetëm një kandidat dhe pa zëvendësues. Pjesa më e madhe e anëtarëve të KED të zgjedhur nuk kanë kaluar ende në procesin e vettingut, dhe se disa prej tyre kanë poste të tjera të larta paralele.

PËRBËRJA E KED 2018-2019	GJENDJA NË VETTING
Vitore Tusha, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese	Kaloi vettingun, me mandat të mbaruar në GJK
Bashkim Dedja, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese	U shkarkua nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit
Ardian Dvorani, Gjyqtar i Gjykatës së Lartë	U konfirmua nga KPK
Arta Marku, Prokurore nga Prokuroria e Përgjithshme	U konfirmua nga KPK
Fatri Islamaj, Gjyqtar nga gjykatat e apelit	Ende pa vetting
Margarita Buhali, Gjyqtare nga gjykatat e apelit	Ende pa vetting
Fatjona Memçaj, Prokurore pranë gjykatave të apelit	U konfirmua nga KPK
Eriol Roshi, Gjyqtar nga gjykatat administrative	Ende pa vetting

Konkretisht, nga 9 anëtarë që duhet të ketë KED, aktualisht ai ka vetëm 7, pasi mungon një anëtar nga Prokuroria e Apelit, si dhe mungon një anëtar nga Gjykata Kushtetuese pas shkarkimit të kreut të kësaj gjykate. Nga anëtarët tanishëm të KED, katër e kanë kaluar vettingun, (Ardian Dvorani, Artan Marku, Vitore Tusha dhe Fatjona Memçaj), dy janë në proces vettingu (Fatri Islamaj dhe Gurali Brahimllari), kurse i fundit, gjyqtarja e apelit, Margarita Buhali, ende nuk është shortuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për të nisur procesin e vettingut.

Kryetar aktual i KED është zgjedhur anëtari i Gjykatës së Lartë Ardian Dvorani, një emër i njohur në karrierën në gjyqësor, por i kontestuar ashpër nga opozita gjatë procesit të vettingut. Sipas njoftimit të Gjykatës së lartë në shkurt 2017, në atë kohë paraqitën kërkesën për anëtar të Gjykatës Kushtetuese gjyqtarët Medi Bici, Ardian Dvorani dhe Luan Hasneziri. Bici është zgjedhur edhe anëtar i KLGJ, ndërkohë që është anëtar zëvendësues në KED, kurse Dvorani është kryetar i KED, pra i strukturës që duhet të bëjë vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese. KED do të përballët në muajt e ardhshëm me sfidën e konfliktit të interesit midis anëtarëve dhe ambicies së tyre për konkurrim për poste të larta në sistemin e ri të qeverisjes së drejtësisë, si dhe me vendimmarrjen e vettingut për disa anëtarë të tij.

2.14. KED, - ROLI I RËNDËSISHËM QË MERR NË MUNGESË TË KONSSENSUSIT

Institucioni i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) ka një rëndësi të madhe në jetësimin e institucioneve të reja të drejtësisë, sidomos në procesin e zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në nivele të tjera të sistemit.

Sipas paketës kushtetuese dhe ligjore, KED për listimin e kandidatëve për poste të ndryshme, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, dhe nëse institucionet e tjera (Kuvendi, Presidenti, etj) nuk bien dakord për votim me shumicë të cilësuar të kandidatëve fitues aplikohet formula sipas të cilës, kandidati i parë i renditur në listën e KED fiton automatikisht. Pra, nga një strukturë që duhet të bëjë vlerësimin teknik të të dhënave të kandidatëve dhe renditjen e tyre mbi bazën e disa kriterëve, KED de facto merr një rëndësi specifike, dhe renditja e saj, në mungesë të konsensusit politik shprehur me votën e shumicës së cilësuar në Kuvend, përcakton fituesit.

Për këtë arsye cilësia e përbërjes, standardet e funksionimit, kriteret e vlerësimit dhe të renditjes dhe praktikat e punës së KED kanë një rëndësi specifike dhe mund të kenë ndikim thelbësor në përbërjen e disa prej institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Përballë kësaj përgjegjësie të madhe do të duhej që KED të kishte përbërje sa më cilësore, të kishte legjitimitet maksimal dhe të veprojë me transparencë dhe standard të lartë. Në gjendjen aktuale KED është ende larg këtyre pritshmërive.

Debat mori edhe praktika e krijimit të KED më 2018. Me vendimin nr.4 të datës 16.11.2018 Komisioni i Pavarur (KPKMN) rekomandoi zgjedhjen e KED të përkohshëm me emërtimin (KPESD) për tu hapur rrugë përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe vijimin e procedurave për përzgjedhjen e emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. KED i ngritur në dhjetor 2017 zhvilloi vetëm një mbledhje, më 19.3.2017. Shumica e anëtarëve të tij përfshirë kryetari u shkarkuan nga organet e vettingut, dhe për pasojë, KED nuk ishte funksional gjatë

gjithë vitit 2018. Sipas ligjit 115/2016 KED ngrihet në fillim të muajit dhjetor me organizimin e hedhjes së shortit nga Presidenti i Republikës.

Në dy rastet, 2016 dhe 2017 Presidenti, në pamundësi ligjore, nuk e ushtroi këtë të drejtë, duke ia lënë hedhjen e shortit Kuvendit. Me shkresën nr.3479 Prot., datë 23.11.2018, Presidenti i Republikës duke iu drejtuar Kryetarit të Kuvendit shprehet se: *“duke vlerësuar rrethanat e faktit ku precedenti i krijuar mbi këtë çështje është aplikuar dhe krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës vlerëson se edhe për këtë vit, Kuvendi është i vetmi organ që ka mundësinë dhe detyrimin për ta zgjidhur këtë situatë.”*

Kuvendi iu drejtuar KLD-së për përcjelljen e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) dhe në përgjigje më 4.12.2018 u depozitua lista me kandidatët. Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, dhe Prokuroria e Përgjithshme i kishin adresuar më përpara listat me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore për KED.

2.15. KLGJ DHE KLP U KRIJUAN, POR DISA SFIDA THELBESORE MBETEN

Megjithëse ishte përcaktuar se krijimi i KLGJ dhe KLP do të ishte faza më e rëndësishme e jetësimit të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë, organet e rivlerësimit nuk bënë përputhje të axhendës së tyre vlerësuese me prioritetet ndaj reformës. Ata u fokusuan në përbërjen e Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese, dhe vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2018 përfshinë kandidatët për KLGJ e KLP në prioritet të vlerësimit të tyre. Procesi i rivlerësimit për kandidatët për këto struktura përfundoi me 23 nëntor, pas një proces të gjatë vlerësimesh, shkarkimesh, thirrjesh të reja për aplikantë për vende vakante, etj.


Në përfundim, nga 16 kandidatë për KLGJ 10 kandidatë u konfirmuan nga KPK, kurse nga 19 kandidatë për KLP gjithashtu 10 kandidatë u konfirmuan nga KPK. Nga kandidatët për KLGJ që u shkarkuan nga KPK bëjnë pjesë Zeneli, Dervishi, Avdyllai, Laze e Treshnjeva, gjyqtarë me karrierë të gjatë deri në Gjykatën e Lartë. Në përfundim në KLGJ bazuar në të dhënat e votimit, u zgjodhën Medi Bici (Gjykata e Lartë), Ilir Toska dhe Brikena Lubonja (Gjykata e Apelit), Dritan Hallunaj, Brunilda Kadi dhe Marçela Shehu (Gjykata e nivelit të parë). Pranë Gjykatës së Lartë kishte dhënë dorëheqje paraprake nga gata gjyqtarja Alma Brati.

Aktualisht KLGJ ka zgjedhur edhe kryetaren (Naureda Llagami) dhe zv/kryetarin Maksim Qoku. Hedhja e shortit në KLGJ përcaktoi mandatet 3 vjeçare për gjyqtarët Brunilda Kadi, Ilir Toska dhe Medi Bici, si dhe jo gjyqtarët Erion Muharremaj dhe Maksim Qoku. Drejtuesja e re e KLGJ, Llagami, është emër kryesisht i panjohur në publik dhe në debatet disave vjeçare të reformës në drejtësi, kurse zv/kryetari është pedagog, por në kundërshtim me parimin ndalues kushtetues 10 vjeçar, vetëm pak vite më parë ka mbajtur post politik në një parti të vogël politike.

Në votimin për KLGJ pati rreth 20% të votave të pavlefshme, një numër shumë i lartë për një trupë cilësore profesionistësh. Tabela më poshtë i ilustron të dhënat e votimit.

VOTIMI PER KESHILLIN E LARTE GJYQESOR	VOTA
PJESEMARRES	339
NUMRI I VOTAVE	2035
VOTA TE VLEFSHME	1694
VOTA TE PAVLEFSHME	341
VOTA TE PAVLEFSHME (%)	20%
FLETE TE DENTUARA	26

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prokurorë (Gentian Osmani, Antoneta Sevdar, Besnik Cani, Bujar Sheshi, Arben Dollapaj, Kostaq Beluli) si dhe 5 jo prokurorë (avokatët Nurihan Seiti (Metaj) dhe Tartar Bazaj, pedagogët Gent Ibrahimimi dhe Sandër Beci, si dhe nga shoqëria civile Alfred Balla). Nga trupa e 305 prokurorëve 283 morën pjesë në votim, 22 nuk morën pjesë në votim. Kryetar i KLP u zgjodh Gent Ibrahimimi, i vetmi ish ekspert i lartë i reformës në drejtësi që mori post në institucionet e reja. Nënkyetar i KLP u zgjodh Alfred Balla, propozim nga shoqëria civile. Edhe në votimin për KLP pati numër të madh të votave të pavlefshme, në total 12.7% e numrit total të gjyqtarëve votues.



Krijimi i KLP u konsiderua një sukses me rëndësi në hedhjen e bazës së qëndrueshme për jetësimin real të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Por duke iu referuar përbërjes së KLP dhe faktit se disa anëtarë të saj në janë proces gjykimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) atëherë nuk mund të thuhet me siguri se KLP është e plotë dhe funksionale. Nga kandidatët për KLP paraprakisht shkarkuan 9 kandidatë (Hoti, Kurti, Nela, Cama, Rreshka,

Sadiku, Nikehasani, Kaloci, Troci) dhe 1 kandidate dha dorëheqjen (Kasmi). Disa anëtarë e rinj të saj, si prokurorët Gentjan Osmani, Antoneta Sevdari e Arben Dopallaj janë në proces gjykimi nga KPA pas ankimimit të bërë nga Komisioneri Publik. Për rastin e prokurorit Osmani ankimimi është bazuar në rekomandimin e ardhur nga Misioni Ndërkombëtar (ONM), kurse në dy rastet e tjera ankimimi është bërë mbi vetë nismën e Komisionerit Publik.

Nëse procesi i gjyqimit dhe vendimit final për 3 anëtarët e KLP merr kohë dhe mund të çojë edhe në shkarkimin e ndonjërit prej tyre (ose të gjithëve), atëherë plotësimi i vendeve vakante do të kërkojë thirrjen edhe njëherë të mbledhjes së Prokurorëve dhe përsëritjen e procedurës për vendet vakante. Nga ana procedurale çështja është e zgjidhur. Problemi krijohet dhe mbetet pa përgjigje nga aspekti i legjitimitetit dhe besimit publik. Anëtarët e KLP, përfshirë 3 prokurorët ende në gjykim nga KPA, vijnë të marrin vendime, të cilat nëse ndonjë ose secili shkarkohen, atëherë do të krijojnë indicien e nevojshme për t'i kontestuar. Vendimet që merren nga prokurorë nën gjykim dhe prokurorë të shkarkuar, kanë vlerë ligjore dhe nuk kanë fuqi prapavepruese, por natyrshëm krijojnë dyshime të forta për legjitimitetin, pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre. Vetë zgjedhja e tyre në KLP pa marrë një vendim final nga KPA, është një formë indirekte presioni mbi KPA, sepse mbështetja maksimale vendore dhe ndërkombëtare që i është dhënë KLGJ dhe KLP mund të lexohet edhe si presion e këshillë për të mbyllur dosjet e tyre hetimore.

Në një komunikim të ONM me median është paralajmëruar se vendimet e KPA janë mbi KLP, dhe nëse ai vendos shkarkimin e prokurorëve në gjykim, atëherë vendimi sjell automatikisht edhe shkarkimin e tyre nga KLP. E drejta dominuese e KPA lidhet edhe me të drejtën e KLP për të shkarkuar anëtarë për *“kryerjen e sjelljes së rëndë profesionale ose etike”*, një përgjegjësi që mund të konsiderohet e tillë nëse KPA merr vendim kundër tyre.

2.16. PRURJET JASHTË SISTEMIT NË KLGJ/KLP: 9 MUAJ ME/PA MANDAT?

Nga periudha kur Kuvendi votoi anëtarët e KLGJ dhe KLP që vijnë jashtë sistemit, deri në periudhën e konstituimit të KLGJ e KLP është një fazë 9 mujore me disa problematika.

- E para, anëtarët e zgjedhur në KLP dhe KLGJ kanë pasur më parë funksione indirekte në sistem (pedagogë të së drejtës, avokatë, noterë, ekspertë vlerësues apo monitorues, etj) dhe nuk kanë ekzistuar rregulla të qarta nëse funksionet e tjera pezullohen në funksion të mandatit të zgjedhur në KLP/KLGJ apo nëse ato vijnë të ushtrohen deri në plotësimin e të gjitha vendeve në këto struktura. Një praktikë e tillë, p.sh, në disa fusha të tjera, si në zgjedhjen e deputetëve, kryetarëve të bashkive apo këshilltarëve, është zgjidhur duke kalkuluar fillimin e mandatit ditën e zgjedhjes së individit nga organi zgjedhor dhe jo ditën e plotësimit të të gjithë trupës së zgjedhur. Në rastin konkret nuk ka rregulla të shkruara dhe as një praktikë transparente se çfarë modeli është zgjedhur. Nga të dhënat e monitorimit të ISP ka pasur disa raste kur individët e zgjedhur nga jashtë sistemit kanë vijuar aktivitetin e tyre, përfshirë edhe funksionet e avokatit në procese gjyqësore ndërkohë që zyrtarisht individë të tilla kanë mandatin kushtetues për të dhënë vlerësime e vendime mbi gjyqtarët e prokurorët, pra mbi palët përballë tij në gjyq.
- E dyta, midis anëtarëve të zgjedhur në KLGJ dhe KLP, në dallim nga parimi kushtetues i kufizimit nga aktivitetet politike dhe postet drejtuese në 10 vitet e fundit, ka raste kur

individë me këto përvoja janë zgjedhur. Nga ana tjetër, vetë procesi i vlerësimit të kandidatëve në Kuvend, krijoi debate të shumta, sepse pati devijim nga renditja në vlerësim dhe vendimmarrje preferenciale. Problematika të tilla vijnë në kundërshtim me pritshmëritë e mëdha publike për reformën në drejtësi dhe standardet e larta drejtuese në institucionet e reja të saj, dhe se çdo devijim, krijon dyshime në standarde dhe lë pasoja në nivelin e besueshmërisë apo të legjitimitetit.

2.17. SHKOLLA E MAGJISTRATURËS: KRIZA ZGJIDHET, REFORMA VIJON

Gjatë vjeshtës së vitit 2018 mazhoranca dhe opozita përfshinë në debatet politike edhe çështjen e Shkollës së Magjistraturës. Ky institucion është përfshirë në Kushtetutë dhe pas vitit 2016 duhet të ketë një strukturë, buxhet, vëmendje dhe rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e jetësimit të reformës në drejtësi. Dy prej funksioneve kryesorë të saj janë, - prurjet e reja në sistem përmes kursit special disavjeçar me kuota fikse për gjyqtarë e prokurorë të rinj, si dhe trajnimi i vazhdueshëm vjetor e periodik për gjyqtarët e prokurorët. Aktualisht Shkolla e Magjistraturës ende nuk ka një seli funksionale të saj dhe mjediset e nevojshme që kërkohen nga zgjerimi i funksioneve, si dhe nuk ka zgjedhur ende strukturat e reja të përcaktuara në legjislacionin e ri.

Problemi kryesor për Shkollën e Magjistraturës për vitin 2018 ishte emërimi i magjistratëve që janë diplomuar, si dhe përcaktimi i kuotave për pranimet e reja në vitin aktual akademik. Ndryshimet kushtetuese e ligjore të vitit 2016 ia njohin këtë kompetencë KLGJ dhe KLP, struktura që nuk ishin të ngritura deri në dhjetor 2018, ndërkohë që nevojat e vendimmarrjes për Shkollën ishin shumë më të hershme në kohë. Në pamundësi për vendimmarrje dhe në mungesë të bazës ligjore për veprim, mazhoranca inicioi një ndërhyrje emergjente në legjislacion për kapërcimin e ngërçit, por për shkak të bojkotit të opozitës në punimet parlamentare shtator-dhjetor 2018, ishte e pamundur të gjendej kompromisi dhe votat e nevojshme për vendimmarrje. Me krijimin e KLGJ dhe KLP ngërçi është zgjidhur dhe dy problemet më emergjente të Shkollës marrin përgjigje.

3. VETTINGU GJATË 2018: BILANCI, TIPARET DHE PROBLEMATIKAT

Gjatë 2018 e gjithë reforma në drejtësi u fokusua në aktivitetin dhe vendimmarrjen e strukturave të vettingut, KPK, IKP dhe KPA. Për këtë arsye, analiza e zhvillimeve në reformën në drejtësi gjatë 2018 meriton të fokusohet në analizën e bilancit të procesit të vettingut dhe në analizën e secilës prej strukturave përbërëse të tij.

Materiali i mëposhtëm paraqet gjetjet kryesore në procesin e vettingut gjatë 2018, bilanci dhe problematikat për secilin nga institucionet.

3.1. KPK: KOMISIONERËT MË TË “ASHPËR” DHE MË “LIBERALË”

Referuar të dhënave të komisionerëve (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit – KPK) rezulton se në vendimmarrjet e vitit 2018, komisionerët kanë pasur raporte të ndryshme vendimmarrëse midis rasteve të konfirmimit dhe të shkarkimit nga funksioni. Kuotat e konfirmimit në detyrë variojnë nga 50% në 59% të rasteve për secilin komisioner, kurse kuotat e shkarkimit nga funksioni variojnë nga 41% në 50% për listën e komisionerëve. Në total përqindja e vlerësimeve pozitive dhe negative për subjektet e rivlerësimit ka diferencë 10% në favor të vendimmarrjeve konfirmuese.

Lidhur me vendimmarrjen e secilit komisioner, rezulton se në vendimet e tre komisionerëve Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komiçi ka barazpeshë 50% me 50% midis vendimeve konfirmuese dhe shkarkimit nga funksioni. Për komisionerët Valbona Sanxhaktari dhe Roland Ilia diferenca midis konfirmimeve në detyrë dhe rasteve të shkarkimit është 4% (nga 52% në 48%). Komisionerja Etleda Çiftja ka diferencë 8% në favor të vendimmarrjeve për konfirmim në detyrë. Katër komisionerë të tjerë, përkatësisht Brunilda Bekteshi, Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko dhe Suela Zhegu diferenca midis vendimeve konfirmuese në detyrë dhe atyre të shkarkimit është e njëjtë, 14% (nga 57% konfirmime në 43% shkarkime). Në fund të listës me kuotën më të lartë të konfirmimeve në detyrë është komisionerja Xhensila Pine me 18% diferencë, nga 59% konfirmime në 41% shkarkime.

Nga të dhënat krahasuese, në vlerë të përgjithshme asnjë komisioner nuk ka më shumë raste të vendimmarrjeve për shkarkim sesa rasteve të vendimmarrjeve për konfirmim në detyrë. Megjithatë të dhënat na lejojnë të dallojmë se komisionerët më të “ashpër” në vendimmarrje janë ata me diferencë 0% midis vlerësimit pozitiv dhe shkarkimeve (Hamitaj, Komiçi dhe Faskaj), ndjekur nga ata me diferencë 4% (Ilia e Bajraktari), kurse komisionerët më “liberalë” janë komisionerët me diferencë të theksuar midis konfirmimeve në detyrë dhe rasteve të shkarkimeve, ku bën dallim Pine me 18%, Zhegu, Qirko, Bungo e Bekteshi me nga 14%.

Tabela aktuale vjetore ka diferencë me tabelën e njëjtë të publikuar për ecurinë e procesit të rivlerësimit deri në gusht 2018. Në tërësi tabela reflekton vetëm të dhënat formale dhe jo përmbajtësore, pasi një analizë e detajuar e treguesve dhe e rasteve mund të nxjerrë në pah cilësi e tregues të tjerë identifikues për secilin komisionerë.

KOMISIONERI	KONFIRMIME	SHKARKIME	DIFERENCA
ALMA FASKAJ	50%	50%	0%
LULZIM HAMITAJ	50%	50%	0%
OLSI KOMIÇI	50%	50%	0%
ROLAND ILIA	52%	48%	4%
VALBONA SANXHAKTARI	52%	48%	4%
FIRDES SHULI	53%	47%	6%
ETLEDA ÇIFTJA	54%	46%	8%
BRUNILDA BEKTESHI	57%	43%	14%
GENTA Tafa (BUNGO)	57%	43%	14%
PAMELA QIRKO	57%	43%	14%
SUELA ZHEGU	57%	43%	14%
XHENSILA PINE	59%	41%	18%
TOTAL	55%	45%	10%

3.2. NGARKESA E PUNËS SIPAS KOMISIONERËVE

Të dhënat nga vendimmarrja e KPK rezultojn se jo të gjithë komisionerët kanë pasur të njëjtën ngarkesë në funksionin e tyre. Disa komisionerë kanë pasur shkëputje për shkak të problemeve shëndetësore, fatkeqësi familjare apo elementë të tjerë, të cilët teknikisht kanë ndikuar edhe në ndarjen dhe përballimin e fluksit të vendimmarrjeve. Referuar të dhënave nga KPK gjatë vitit 2018 komisionerët kanë pasur 231 angazhime në trupa gjyqesore në seanca dëgjimore.

KOMISIONERËT	VENDIME	NË PËRQINDJE
ALMA FASKAJ	4	2%
ETLEDA ÇIFTJA	13	6%
LULZIM HAMITAJ	16	7%
OLSI KOMIÇI	18	8%
FIRDES SHULI	19	8%
SUELA ZHEGU	21	9%
GENTA Tafa (BUNGO)	21	9%
BRUNILDA BEKTESHI	21	9%
PAMELA QIRKO	21	9%
VALBONA SANXHAKTARI	23	10%
XHENSILA PINE	27	12%
ROLAND ILIA	27	12%

Në total, numrin më të madh të angazhimeve, goftë si vlerë numerike ashtu edhe në përqindjen totale të angazhimit të KPK-së e kanë pasur komisionerët Xhensila Pine dhe Roland Ilia me

përkatësisht 27 seanca dhe në total në 12% të totalit të seancave për secilin prej tyre. Në vendin e tretë me ngarkesën më të madhe është komisionerja Valbona Sanxhaktari me 23 seanca dhe 10% të numrit total, ndjekur nga katër komisionerët Suela Zhegu, Genta Tafa (Bungo), Brunilda Bekteshi dhe Pamela Qirko me përkatësisht 21 seanca ose 9% të totalit të rasteve të vendimmarrjeve në KPK.

Komisionerët me numrin më të vogël të angazhimeve dhe të vendimmarrjeve janë Alma Faskaj me 4 seanca dhe rreth 2% në total të vendimmarrjeve të KPK, Etleda Çiftja me 13 seanca dhe 6% në total, Lulzim Hamitaj me 16 seanca dhe 7% në total, si dhe komisionerët Firdes Shuli e Olsi Komiçi me përkatësisht 19 dhe 18 seanca, ose vlerë rreth 8% në numrin total të seancave për secilin prej tyre.

3.3. KOMISIONERËT QË U RRËZUAN NGA ONM/IKP DHE KOLEGJI

Një tregues profesional për efikasitetin e vendimmarrjeve mund të vlerësohet edhe raporti i cdo komisioneri me procesin e animimit të iniciuar nga Misioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) ose nga Komisioneri Publik (IKP). Nga të dhënat e vitit 2018 rezulton se nga 16 ankimime, 4 lidhen me procedura teknike të dorëheqjeve të subjekteve të rivlerësimit, kurse 12 lidhen me vendimmarrjet e KPK për konfirmimin e tyre në detyrë. Pikërisht këto të fundit kanë vlerë analize dhe janë paraqitur sipas komisionerëve në tabelat bashkëngjitur.

Nga tabela rezulton se numri më i lartë i vendimeve të animimit nga rekomandimet e ONM ose nisma e vetë IKP i përket komisionerit Roland Ilia (7 nga 12) në total 19% të të gjithë rasteve. Në vendin e dytë me numër të njëjtë të vendimeve të ankimuara nga ONM / IKP janë komisionerët Pamela Qirko dhe Firdes Shuli, me përkatësisht 5 raste secila ose 14% të të gjitha rasteve për secilën.


VENDIMET E KPK TE ANKIMUARA IKP/ONM	
KOMISIONIERI	NUMRI I VENDIMEVE
ALMA FASKAJ	0
ETLEDA ÇIFTJA	0
BRUNILDA BEKTESHI	2
SUELA ZHEGU	2
VALBONA SANXHAKTARI	2
XHENSILA PINE	2
LULZIM HAMITAJ	3
GENTA Tafa (BUNGO)	4
OLSI KOMIÇI	4
FIRDES SHULI	5
PAMELA QIRKO	5
ROLAND ILIA	7

Drejtuesja e KPK, Genta Tafa (Bungo) dhe komisioneri Olsi Komiçi pasojnë me kuotë të njëjtë të vendimmarrjeve të tyre të ankimuar në Kolegin e Posacëm të Apelimit, me nga 4 vendimmarrje ose në total, 14% të numrit të përgjithshëm të animimeve. Për komisionerët e tjerë rastet e ankimeve ndaj vendimeve të tyre janë midis 2 dhe 3 ose 6%-8% të të gjitha rasteve, kurse për dy komisionere nuk ka asnjë rast të vendimmarrjes së tyre që është ankimuar. Për shkak të numrit të vogël të rasteve të trajtuara nga komisionerja Alma Faskaj, rezulton se treguesit më të lartë pozitivë i ka komisionerja Etleda Çiftja me 0 ankime nga 13 vendime ku ajo ka marrë pjesë si anëtare, relatore ose drejtuese e trupës.

3.4. NË 8% TË RASTEVE VENDIMET U MORËN ME 1 VOTË MË SHUMË

Të dhënat e deritanishme të ecurisë së vettingut treguan se në 92% të vendimeve të KPK vendimmarrja ishte unanime, - 3 me 0 nga trupa prej 3 anëtarësh. Në rastet e tjera, në total 6 raste ose 8% të vendimeve të KPK, nga të cilat, 4 janë vendime shkarkimi dhe 2 janë vendime konfirmimi në detyrë, vendimmarrja ka qenë me shumicë votash, ku një votë vendos diferencën.

Konkretisht, tabela ilustron vendimmarrjet me shumicë votash, ku në listë bëjnë pjesë vendimmarrjet konfirmuese për kryetarin e Gjykatës Kushtetuese Dedja dhe gjyqtarin e Gjykatës Administrative Medja, si dhe vendimet për shkarkim për dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (Xhoxhaj e Hoxha) dhe një anëtar në Gjykatën e Lartë (Broci).



Referuar komisionerëve që kanë marrë vendime në pakicë, rezulton se komisionerja Xhensila Pine ka qenë 3 herë në pakicë, pra në 50% të të gjitha rasteve të vendimeve me shumicë votash. Pine ka votuar kundër shkarkimit të anëtarit të Gjykatës së Lartë A.Broci, si dhe ka votuar pro shkarkimit të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese B.Dedja e gjyqtarit G.Medja. Nga vendimet e deritanishme të KPA, Pine rezultoi se ka pasur të drejtë në votën e rastit të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, kurse rastet e tjera janë ende në shqyrtim.

Komisionerët e tjerë që kanë votuar në pakicë, janë Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Valbona Sanxhaktari, secili nga një rast. Nga vendimet e deritanishme të KPA rezulton se vota kundër shkarkimit e kryetares së KPK Tafa (Bungo) ndaj gjyqtares Xhoxhaj ka qenë e gabuar, siç edhe vota e komisioneres Sanxhaktari kundër shkarkimit të gjyqtarit Hoxhaj ka qenë gjithashtu e gabuar. Për rastin e votës në pakicë të komisionerit Roland Ilia, ende nuk ka vendim verifikues në KPA.

SUBJEKTET E RIVLERESIMIT 2 VS 1 VOTA	KRYETAR/E	RELATOR/E	ANETAR/E
ALTINA XHOXHAI, GJYQTARE, GJYKATA KUSHTETUESE	E.ÇIFTJA	B. BEKTESHI	G. Tafa (BUNGO)
FATMIR HOXHA, GJYQTAR, GJYKATA KUSHTETUESE	Xh. PINE	A. FASKAJ	V. SANXHAKTARI
ARTOR YLLI, NDIHMËS, GJYKATA ADMINISTRATIVE	E. ÇIFTJA	R. ILIA	B. BEKTESHI
ARTAN BROCI, GJYQTAR, GJYKATA E LARTË	Xh. PINE	V. SANXHAKTARI	E. ÇIFTJA
BASHKIM DEDJA, GJYQTAR, GJYKATA KUSHTETUESE	V. SANXHAKTARI	Xh. PINE	R. ILIA
GENTIAN MEDJA, GJYQTAR, GJYK. ADMINISTRATIVE	R. ILIA	F. SHULI	Xh. PINE

Në total, referuar vendimmarrjes së deritanishme të KPA rezulton se Xhensila Pine ka pasur të drejtë në vendimmarrjen e saj si pakicë në dy rastet Hoxha dhe Dedja, Valbona Sanxhaktari nuk ka pasur të drejtë në dy rastet Hoxha dhe Dedja, Genta Tafa (Bungo) nuk ka pasur të drejtë në rastin Xhoxhaj, Roland Ilia nuk ka pasur të drejtë në rastin Dedja, Alma Faskaj ka pasur të drejtë në rastin Hoxha, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja kanë pasur të drejtë në rastin Xhoxhaj.

Ky aspekt i analizës nuk shpreh detyrimisht fajësi apo aftësi të veçuara për komisionerët, por ndihmon të analizohen edhe në të ardhmen dy tregues të rëndësishëm: e para, që vendimmarrjet me një votë diferencë janë gjithnjë të debatueshme dhe ndonjëherë luan rol edhe vetë shorti i trupës gjyquese që caktohet; dhe e dyta, fakti se disa komisionerë shprehin opinione e marrin vendime, të cilat nuk konfirmohen në KPA, është tregues i debatit kritik mbi standardet që aplikohen në gjykimin e tyre dhe i debatit mbi aftësinë profesionale si për të ruajtur standarde të njëjta për të gjitha subjektet ashtu edhe për të lexuar të njëjtat fakte me të njëjtën gjuhë ligjore.

Në krahasimin e numrit total të vendimeve dhe numrit të atyre vendimeve që janë kontestuar nga ONM ose janë ankimuar me nismën e vetë IKP, ka gjetje interesante. Për shembull, dy komisionerët Firdes Shuli dhe Roland Ilia kanë përqindje shumë të lartë të vendimeve që u janë kontestuar dhe janë në proces shqyrtimi në KPA.

Konkretisht secilit prej tyre u janë kontestuar 26% të vendimeve të marra, një shifër shumë e lartë për një proces kaq të rëndësishëm sa rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Edhe komisionerët Pamela Qirko dhe Olsi Komiçi kanë përqindje mbi 22% të vendimeve të kontestuara dhe të ankimuar nga ONM/IKP. Nëse në total janë kontestuar 16% e vendimeve, mbi këtë mesatare gjenden 6 nga 12 komisionerët, pra 50% e tyre.

Për rrjedhje, kur ka nivel kaq të lartë kontestimi dhe kur kur ka komisionerë me disbalanca të theksuara midis vendimeve të dhëna dhe shkallës së kontestimit të tyre ligjor nga ONM e IKP, atëherë është e qartë se vendimmarrjet kanë pasur problematika, nuk janë aplikuar të njëjtat standarde nga të gjithë komisionerët dhe se “faktori njeri” ka peshë me rëndësi në vendimmarrjet e strukturave të KPK-së.

PËRQINDJA E VENDIMEVE TË KOMISIONERËVE QË JANË ANKIMUAR NGA IKP/ONM	
FIRDES SHULI	26%
ROLAND ILIA	26%
PAMELA QIRKO	24%
OLSI KOMIÇI	22%
LULZIM HAMITAJ	19%
GENTA Tafa (BUNGO)	19%
BRUNILDA BEKTESHI	10%
SUELA ZHEGU	10%
VALBONA SANXHAKTARI	9%
XHENSILA PINE	7%
ALMA FASKAJ	0%
ETLEDA ÇIFTJA	0%

3.5. KOLEGJI I POSAÇËM: SHKARKIME NË 100% TË RASTEVE

Kolegji i Posaçëm i Apelit është organ shumë më i rëndësishëm sesa KPK dhe ka rol thelbësor në dhënien e drejtësisë, në krijimin e normave dhe në standardet e larta që meriton procesi reformues në drejtësi. Gjatë fillimit të vitit 2018 Kolegji pati raste minimale të gjykimit, kryesisht për shkak të vonesave në ecurinë e çështjeve tek KPK dhe për vetë natyrën e punës së tij.

Gjatë vitit 2018 në tërësi KPA mori 12 vendime që lidhen me subjektet e rivlerësimit, nga të cilat, në 9 raste vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit rivlerësues, në 2 raste vendosi masa penalizues përjashtimi nga sistemi për 15 vjet për subjekte që kanë dhënë dorëheqje dhe për 1 rast vendosi pezullimin e çështjes për shkak të dorëheqjes së subjektit në moshën natyrale të pensionit. Ndër vendimet më të rëndësishme të KPA është ai që lidhet me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese B.Dedja, i cili e kaloi vettingun në KPK, por vendimi u ankimua nga ONM dhe IKP. Më 17 dhjetor 2018 KPA vendosi shkarkimin e tij, - vendimi më i rëndësishëm i marrë deri tani nga organet e vettingut. Ka një opinion të gjerë publik me bindjen se zoti Dedja nuk ka bërë pjesë dhe as nuk është etiketuar asnjëherë gjatë viteve për korrupsion, dhe se subjekte me më shumë problem se ai e kaluan lehtësisht vettingun, por KPA vendosi bazuar në dokumentacionin teknik të ofruar dhe elementë të tjerë, të cilët nuk kanë lidhje me opinionin publik.


Vendim tjetër me rëndësi në proces është ai ndaj anëtarit të Gjykatës së Lartë Edmond Islamaj, i cili gjithashtu e kaloi me sukses vettingun në KPK. Pretendimet janë shqyrtuar në disa séance dhe pritjet që brenda muajit janar të ketë një vendim përfundimtar. Vendime të tjera të

rëndësishme në proces janë ato që lidhen me anëtarë tashmë të zgjedhur të KLP dhe KLGJ që janë ankimuar.

KOLEGJI I APELIMIT	NR	NE PERQINDJE
VENDIME TOTAL	12	100%
KUNDER KPK	0	0%
SHKARKIME/NDALIM	12	100%

Vetëm në dy raste vendimmarrjet e KPA janë shoqëruar edhe me debate dhe votë publike jo konsensuale midis anëtarëve. Rasti i parë lidhet me vendimin e datës 10 korrik mbi subjektin e rivlerësimit Sulejman Tota, ish prokuror i dalë në pension, ku gjyqtari Sokol Çomo votoi në pakicë kundër vendimit të shumicës. Rasti i dytë lidhet me vendimin e ndaj subjektit Fatmir Hoxha, ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese, vendim i marrë më 25 shtator 2018. Edhe në këtë rast gjyqtarët morën vendim me shumicë votash, ku minorancë u deklarua Ina Rama, ish Prokurore e Përgjithshme dhe tani anëtare e KPA-së.


Rasti i vetëm kur një gjyqtar ka dhënë dorëheqje nga gjykimi për shkak të kërkesës së subjektit rivlerësues dhe pretendimit të tij për konflikt interesi, është dorëheqja e gjyqtarit Sokol Çomo nga gjykimi i ankimit të ish anëtarit të Gjykatës së Lartë, Artan Zeneli.



Në total KPA ka dhënë 12 vendime me trupe prej 5 gjyqtarësh, pra me 60 vendime totale të trupës gjyqësore. Tabela ilustron vendimmarrjen dhe numrin e rasteve të angazhimit për secilin gjyqtar në KPA. Sipas tabelës, rezulton se Ardian Hajdari ka pasur numrin më të madh të rasteve të angazhuara, 10 raste, rreth 17% e të gjitha rasteve të gjykuara. Pas tij janë me numër të njëjtë çështjes tre gjyqtarë, - Luan Daci, Natasha Mulaj dhe Albana Shtylla. Me numër të njëjtë çështjes janë edhe gjyqtarët pasues, Rezarta Schuetz dhe Ina Rama, me përkatësisht 8 çështje të gjykuara. Numrin më të vogël të çështjeve të gjykuara e ka gjyqtari Sokol Çomo me 7 raste, nga 12 trupa gjyqësore në total. Vlen të theksohet se Kolegji ndërkohë ka disa çështje të tjera në shqyrtim, ku të gjithë anëtarët e tij, sipas shortit, janë pjesë e trupës vendimmarrëse gjyqësore.


Në përfundim të 12 rasteve të mbyllura deri tani nga KPA mund të bëhet një kalkulim i kohëzgjatjes së çështjeve nga fillimi i shqyrtimit në KPK dhe deri në vendimmarrjen finale në KPA. Bazuar në analizën e të dhënave për rastet e mbyllura, rezulton se ka pasur çështje, të cilat kanë kërkuar më shumë se 170 ditë kohë shqyrtimi në dy nivelet deri tek vendimi përfundimtar, duke llogaritur në disa raste edhe periudhën kalendarike të pushimeve. Në vendimmarrjet e fundit (shtator-nëntor 2018) ka rënie të ditëve në dispozicion për të marrë një vendim final, nga 125-130 mesatarisht në pjesën tjetër të vitit, tek 70-76 mesatarisht në pjesën e fundit të vitit. Kjo e dhënë flet për katër tendenca:

- E para, proceset e rivlerësimit në dy shkallët e organeve të vettingut kërkojnë shumë kohë në dispozicion, shpesh, shumë më tepër sesa perceptimi dhe pritshmëria publike. Kjo ndodh edhe për rastet më flagrante, kur fajësia ose shkelja e ligjit nga ana e subjektit është lehtësisht e identifikueshme.
- E dyta, KPA ka rritur performancën e vet nga praktikat e para eksperimentale tek praktikat e fundit shumë më të debatuar dhe më profesionale.
- E treta, KPA ende nuk ka dhënë vlerësime konfirmuese për subjektet e rivlerësimit, duke krijuar përshtypjen se më shumë se instancë finale është një ndëshkuese edhe më e ashpër sesa KPK.
- E fundit, zgjatja mesatare me 116 ditë për një rast rivlerësimi është kuotë shumë e lartë për nevojat e mëdha që vendi ka për ecuri më të shpejtë të procesit të rivlerësimit dhe për institucione funksionale në sistemin e ri të drejtësisë.



3.6. KOMISIONERI PUBLIK: ANIMIME NDAJ 17% TË VENDIMEVE TË KPK

Komisioneri Publik ka një rol thelbësor në jetësimin integral të procesit të rivlerësimit dhe në garantimin e një standardi sa më të lartë të hetimit, gjyqimit dhe të vendimmarrjes, si dhe në mbrojtjen e interesit publik. Deri në fund të vitit 2018, Komisioneri Publik ende nuk është vendosur në sprovë reale, kryesisht për shkak të numrit të vogël të subjekteve të kaluara në vetting dhe asistencës së përhershme të ONM. Megjithatë, në vendimet e deritanishme të IKP rezulton se nga 77 raste të vendimeve të KPK dhe 16 ankimimeve të bëra nga IKP në 38% të rasteve ka qenë nisma e ardhur në formën e rekomandimit nga ONM që ka çuar në ankimimin zyrtar nga ana e IKP. Në 62% të rasteve të tjera, nisma ka qenë e vetë e IKP. Ndër rastet më të bujshme nga vetë nisma e IKP janë ankimimet kundër drejtuesve të Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese.



Vendimmarrjet e IKP dhe rekomandimet e ONM, në tërësi janë mirëpritur nga grupet monitoruese shqiptare dhe opinioni publik, megjithatë ka një sërë të dhënash që vënë në dyshim standardin e përdorur për rastet e ankimimit dhe rastet e tjera ku sidomos IKP ka vendosur mos-ankimime. Disa prej subjekteve të kaluara me sukses në KPK u kontestuan gjërësisht nga aktorë të ndryshëm politikë e mediatikë për shkak të problematikave në justifikimin e burimeve të tyre financiare si dhe në ushtrimin e funksionit në sistemin e drejtësisë. Kritikrat e tyre përgjithësisht nuk u morën në konsideratë.

Më shumë se reflektimi ndaj kritikave, problematike mbetet niveli kritik i transparencës mbi rastet e mosankimimeve dhe ndaj pretendimeve kritike që vijnë nga institucione, qytetarë dhe grupe të tjera të interesuara për një standard sa më të lartë të vlerësimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nëse ONM ka një mandat tjetër dhe llogaridhënia e tij është e pamundur të ushtrohet në rastin shqiptar, pavarësisht se funksioni i saj nuk është realisht vetëm monitorues e rekomandues, por shumë më tepër sesa kaq, - IKP ka një rol e përgjegjësi më të madhe publike dhe ndaj duhet të krijojë mekanizma që krijojnë një raport më të lartë besimi ndaj publikut dhe ndaj integritetit të reformë në drejtësi.